

**Francesco Antonio Santori**

# **OPERE VARIE**



**Edizione del testo albanese**

**a cura di**

**Vincenzo Belmonte**



**Francesco Antonio Santori**

# **OPERE VARIE**

Edizione del testo albanese

a cura di

Vincenzo Belmonte

© 2018 Tutti i diritti sono riservati

## INDICE

Introduzione 7

Il canzoniere albanese 9

Rapsodhīt - *Le rapsodie* 22

Satirat - *Le satire* 61

Rime sparse 110



## FRANCESCO ANTONIO SANTORI

Francesco Antonio Santori<sup>1</sup> nacque da povera famiglia nel 1819 a Picilia/Santa Caterina Albanese, in provincia di Cosenza. Entrato a San Marco Argentano nell'ordine dei Francescani Riformati, vi ottenne incarichi prestigiosi, ma nel 1860 preferì ritirarsi nel paese natale, dove si ridusse, per vivere, a dare lezioni private e a costruire ingegnosi attrezzi artigianali. Nel 1876 ottenne l'incarico di parroco a San Giacomo di Cerzeto, ove morì nel 1894.

La sua fu una vita povera di eventi, dedicata alla composizione di opere in albanese che spaziano in tutti i generi letterari e la cui importanza viene sempre meglio riconosciuta man mano che procede la pubblicazione dei manoscritti. A lui si attribuisce il merito di aver introdotto nella letteratura albanese il dramma e il romanzo.

Nella presente selezione, che prelude all'edizione dell'Opera Omnia, si è inteso dare la preferenza a testi per lo più inediti o mai più ripubblicati dove è possibile rinvenire alcune tra le sue pagine più valide dal punto di vista artistico. In tal modo la pubblicazione completa delle opere religiose e teatrali e delle *Rapsodie* (per lo più sue creazioni originali) finirà con il consacrare il valore poetico del Santori.

La sua visione del mondo in compendio si può individuare nei versi del dramma *Miloscino* (649-653), dove l'uomo viene descritto come

meteora  
che in aria resta accesa  
un attimo, poi cade  
in oscuro deserto, divorante  
sempre per rimanere ognora vuoto.

## OPERE VARIE

Questa terza sezione ospita una nuova e, si spera, più attendibile trascrizione di due opere già da altri precedentemente edite, *Il Canzoniere albanese* e *Le Satire*. Nelle *Rime sparse* vengono raccolte poesie rinvenute frugando tra i manoscritti della Biblioteca Civica di Cosenza. Ma il testo più interessante della sezione è senz'altro quello delle *Rapsodie* (finora solo parzialmente pubblicate), dove il Santori, ispirandosi ai canti popolari, produce alcune tra le sue creazioni più convincenti e veramente emblematiche dell'anima arbëreshe.

Diversamente che per le opere religiose e teatrali, a questi testi santoriani non segue la traduzione. Questa, che non poteva essere buttata giù *invita Minerva*, cioè senza ispirazione, *differtur, non aufertur*. Intanto si è preferito non rinviare per gli studiosi la fruizione del testo albanese. Il

---

<sup>1</sup> L'atto di nascita riporta: *Francesco Paolo Santoro*; l'atto di morte: *Francescantonio Santoro*. Antonio era il nome da religioso. Per il cognome è prevalsa la forma Santori, usata anche dallo scrittore.

vantaggio dell'edizione elettronica è chiaramente anche quello di permettere il perfezionamento, nel tempo, della pubblicazione.

### CRITERI DELL'EDIZIONE

Il Santori, come è noto, usa un suo personale alfabeto che viene di volta in volta qua e là modificato. Di conseguenza sarebbe necessario studiare l'alfabeto di ciascun testo. Ritengo più opportuno dedicare in seguito all'alfabeto del Santori uno studio a parte che tenga conto di *tutti* i suoi scritti. Per ora rinvio agli studi parziali sull'argomento, che non mancano. Se mi sia attenuto a criteri scientifici nella trascrizione, lo si potrà giudicare dalla coerenza interna e dai chiarimenti inseriti nelle note, dove si rende conto anche degli interventi correttivi su errori di stampa o lapsus calami. Particolarmente difficile è stato individuare il discrimine tra svista e intenzione dell'autore nell'oscillazione tra *u* e *ë* atone. Avverto che ho trascritto le grafie santoriane *-mp-*, *-nt-*, *-nc-* rispettivamente con *-mb-*, *-nd-* e *-ng-*, seguendo la pronuncia comune. Ho reso con il segno *h* l'aspirata in uso nel paese natale dell'autore, nonostante le grafie del tipo *ghami* adottate per influsso del De Rada. La punteggiatura è stata resa più conforme all'uso attuale. Ho aggiunto l'accento grave per chiarire casi dubbi, mentre invece, brandendo il rasoio di Ockham, ho sfrondata l'originale della pleora di accenti gravi e acuti. Gli accenti circonflessi (il cui uso non corrisponde a quello del De Rada) li ho considerati equivalenti al raddoppiamento della vocale, trascrivendo, ad esempio, con *ī* sia *ii* che *î*. Tra parentesi quadre ho inserito le integrazioni editoriali, che riguardano sovente i titoli che l'autore ha trascurato di apporre. Per problemi generali di impostazione può essere utile consultare le introduzioni alle mie edizioni critiche della *Gjella* del Variboba e dello *Skanderbeku i pafān* del De Rada, entrambe del 2005.

Un grazie particolare devo al prof. Francesco Altimari per aver risolto innumerevoli dubbi e messo a mia completa disposizione le riproduzioni dei manoscritti, oltre a consentire l'inserimento nel sito dell'Università della Calabria (<http://www.albanologia.unical.it>) di questa pubblicazione, per l'aspetto tecnico curata con la consueta solerzia e professionalità dall'ing. Battista Sposato.



# I L CANZONIERE ALBANESE

Sa hjë të kã ajo këz!  
Rin, Rin, ô, ku vajte sot?

*Vjershi Maqit*

1.

Për dîr, për namurî shûm vjershe shkruajta,  
moj ndë ktë zëmër namurî së ndieta:  
ndë gjëll sa mbeta ndonjë kopile së ruata,  
e vetëm at[ë çë] dhjovasa ani rrëfieta.

Qeva ndë dhë e tas me dhën së luata 5  
e ndë të mira o liga tij s' u lajta,  
se, nd' atë shkurtur mot çë vasha ruata,  
isha paftes e mëngu ç' ishin pieta.

2. Odhî e I

Ti pa zëmër kuqullore tx: kuqullore  
vajz çë faqen mose fsheh,  
të dashurt si nëng e njeh?  
Çë vet krahët gjelbullore tx: gjelbulore  
më buthton e dishëron 5  
se të klânj, e ng' e ndërron  
me hadhî lipin njinje.

O! via, prîr ballin e bårdh  
çë shëron zëmrat sëmûr.  
Leshtë arëm, çë si grûr 10  
mârr nga era dridhet, ârdh  
nëng u pã nga rrasu dhë,  
ndo si jotja jetër hjë  
o ndë gjëll çë shkoi vo qe.

At Parrajs bukurîe 15  
pse shehën e ngë buthton,  
me kë gjith jetën ti hajdhon  
është je i mbjedhur te ata krie?  
Buthtoja dashurit [t]jënd:

mos e duaj mjër, mos e rënd, kūr me lot e kūr me lip.	20	
Me një gaz hajdhosi gjīn, me një fjālë këshillin nxīri ç' e meron, e ngatha hiri zjarmin, ç' e lavosi e nxīn, lēfare me një të ruar. O kopile, të qofsha truar, kēt harē, k' u dua, më jip.	25	
Si lulja çë delë nga gjëmbi, dolle prindve jo bulër. E fanme qe ajo hēr; i lumë i diellit rrëmbi pār çë të shkëlëqeu ndër faqe. O e zilime monosaqe, kush të puthi të kuqen bŭz?	30	tx: bulār
Nani gjith mbi tīj thërret ulëtëllōr e të lertë trima: ëmri it si bumbëllima nëng qëndron te vendi qet, ku ti leve, e bumbllisōr vete fōrmbëdhave hōr. Zëmrat lidhën me tērkuz.	40	tx: ulëtëllōr te] tx: lle
Qeshën, vajz, e sīt e zez turpsōr mbanë ndë trōll e s' frīn ndër zëmra vōll malli, çë hjēs [s]ate u dhez: nd' i dërgon një hēr përnën, ti ndër djale ushtrën bën, kë llumbardhashit petriti.	45	
Bāllt [t]ënd illet gëzon, fton hënën të të shōh, dielli vjen më ndën të njōh bukurīn çë të larton. Po ndë zëmren ai të paft, "O s'namure," - ahiena thot - "kush ndë dhē ethtos të shtiti?".	50	55

### 3. Vjershi I

O vash çë pjeksur siell ari këshën  
e mua të mjerit më tramaksën gjīn,

kūr ti pā skemandilē ka kroi vjēn,  
je holla ēr ndē shpatulla të frīn,

ti bëne e kuqe e ballët të shkëlëqēn 5  
e t' tjerat përtej nēn kopile nxīn.  
Sa siu gazōr je qeshmja bŭz vëlēn,  
sē thom u gjē, se atje ka malli shpīn.

#### 4. Vjershi II

Trëndafile çē ndē maj fjetat gjelēbon  
e prēhrin hapēn, e kuqe tupit nēn,  
dēlire jep pjaxhīr e dhēn hajdhon:  
ashtu ti, vash, harēn mbī t' tjera zgjon,

se ku ti gjēnde vashat bukuron 5  
e shpivet ku pushon me faqe i bēn  
ndēr, sa mē njeriu nēng e dēlēgon,  
e ndē katunde, ku t' arvosh, ng' anxēn.

#### 5. Vjershi III

Kur ti këndon, mbē t' qet vëhet puhjā,  
e trolli e driza e bari rrī të ndienj,  
e zogu ambnōr pushon te lajthīa,  
e një burīth lē dheun të grrienj.

E lot't shīn pa sqep mjera Rrēdhīa. 5  
U vet pa levrosī mē faqen lānj  
me lotē tharta e mē m' arrvon hjidhīa,  
sa mēngu kam fuqī shokēt t' i pienj.

#### 6. Këndëk e I

Ndē mot çē rrijin bashk  
ulēku, kaciqi e dhia,  
u thom se namuria  
sē ndihej mīr ndē dhē.

O thomse ndonj kopile 5  
ndē doj një trim i lart,  
kētij s' i bënej thart  
t' e doj, t' i vëj rē.

Zakoni shūm i but  
i mbaj pather nd' ambnī,  
e gjith i mbjidh një shpī  
e s' in ushtra nd' ata. 10

Një tries rrotull i shih  
e pjonu gjith të mira;  
llarghu rrazbisej dira  
e gazi rrōj për ta. 15

Moj qe kī mot një gjūm,  
se mose ndē kēt dhē  
qe lip, hjidhī e harē,  
si kā nani kush do. 20

Një qan e një këndon, tx: qani  
kush qeshën e kush këcën,  
një e lutën e një harēn  
e kā e nëng e përdo.

#### 7. Vjershi IV

O vash, thuame nd' arrū dishēnuame hera,  
ndo na haraksi ka Parrajsēt illi  
fanmīr, ndo neve qaset paravera,  
ndo dhafna lulēzoi, e te fingjilli

u rrodh vāmb e harēm, se tas mua çera 5  
nga trimbsimi e bārdh m' u bē si dilli,  
e tas harea më spavet, si tek era  
shprishet buhoi e bora ikën te prilli.

#### 8. Kangjel-e i valles

Faqe moti kish ndërruar;  
gjaku e i trimavet t' abresh  
nëng derdhej mē si lūm;  
po ambnia kishë pushuar  
te hōrt e moçēme; e trimat 5  
bashk me vashat t' abresha  
me këndim çē lumsonoj  
dridhin valle ndër katundet,  
kūr namuri dālë e dālë  
zū të mbillnej nd' ato zēmra 10  
të tīn pāmundur fuqī.  
Para grua ghavnare vash  
çē buthtoi gjīrin të dhezur  
pjonu zjarrit namurīje

qe e bukura Ëngjëlīn për të ndermin Milloshin. Katër trima e dimbëdhjet vasha të zgjedhura mbi gjith zonjat ç' ishin Musaqan, bukura sa më ng' u tha,	15    20	
me stolī mundashi të hōll të rēnda perllash e ār, valle dridhjin për ndē hōr. I bīr-e i zotit Sullit shkon' e vej ndē krēmte madhe, kë mbanej Iskandri Krōj për të pasur'n lefterī mbi të spavura hjidhī. Katër kuelē me shērbētōr sīll trimi formadh t' armatosur e shkëlëqiem si ushtërtōr çē nd' ushtër vēn. Kūr te Musaqana hiri prapa nji pēllasi ndieti aso këndimje hadhjār, sa dualltin te jetēr ūdh çē s' i vij trimit kundrēlē. Mbet e zoti se të shih at valle ashtu dēlīr çē haraksi e t' i sison zū ato vasha një për një. Si t' e pesmja sīu arrvoi s' mudi mē përpara vej. Një kopīle, me di sī mē se illi të shkëlëqiem, di akulē t' ēndmje fuqī te stomachji i dritsoi, ku m' i bëri një lavōm kë nëng i shēroi njerī sa duroi mjeli ndē dhē, ku sē pati mē harē. Ish fōrmadhja Ëngjëlīn ajo vash çē pat fān të prēn e dlīr të ruamt te stomachji trimit huaj. Moj gjī-frītura kopile ajo edhe te zēmra ndieti moznedjare kopanē. Uli sīt e sē këndoi sa duroi vallja at ditē, se një noēr fare dēlīr mose para i shtroi ndër sī at të huaj pjotē ghavnī. Trimi tas prapa qëndroi	25    30    35    40    45    50    55    60	tx: Soullit

si hroāz e këshillonej bukurīn e të hjeshtes vash e i grisej zëmra.	65	
Thirri e një të shërbëtorvet, kuj i taksi një aspet t' art, nd' e arrëj të xëj kush ish	70	
ajo e pesmja kopile çë me zā të thjell e ëmbëlë më se gjith vallen nderoi, me të veshura mundashi, me xhipun e gjelëberin,	75	
me të holl sqep e të bārdh më se bora, mo pā kēz. Shërbëtori ju përgjegjë: "Zoti im, përdashur im, mos kīj fare trimbsim, se përpara t' arrvōnj errësira, e dheut t' i shtrōnj sqep e saj t' ohjistër e gjër, bi' t' xësh kush ish kopilja çë m' e mbanej vënd e pesëm".	80	
Mirfill kūr dielli të madhe perëndimën doj t' arrvoj, shërbëtori arrū e tha: " Mori zot i madhështim, vajza çë të pestin vend mbāj te vallja ghonovare është e bilja e zotit madh çë mbrezon ndë Musaqan".	85	tx: t' okistër
Zoti dha një shertim kūr gjegji këto fjalë. Prana pieti: "E si ja thōn asaj zōnj emrin?" U përgjegj te shërbëtori: "Ëmri i bukurë sī kurmi: zonja Ëngjellin je thōn!".	90	
Trimit i përqeshi faqen këjo fjalë, e mbeti qet e vate mbë dritësorë e, u kumbistë te dora, vrenej. Vajza, arrën po ndë pëllast, jo si para pjonon gaz vej te jëma e dorën i puth', mbjidhej prā ndë saj mēnī.	95	
Qe kjo vet e para hër çë m' u mbjodh e vate nje ndë mēnī të xheshej drej. Ndiej një mall e s' e dëlëgonej; lutnej shumë e nëng dīj ajo vet atë çë doj.	100	tx: te [riempitivo]
	105	
	110	

Moj ndër si pather përpara i rrij hjea e atij kopili. Thirri një norë kriate, je dërgoi të hōll-hōll xëj kush ish i huaji zot çë ndë kapilljon pushoi prej aghorës. Vajza vate. Kūr arrū, ndë dritsōr pā formadhin djalëzōr. Hiri mbrënda e një kriate...	115
Po u lodha. E zëm papā nj'etër dit çë të kēm harē.	120
	125

## 9. Vjershi V

Lulez e gazëm, njera kūr të rrish  
jo imja, buza e llārgħ çë të luton?  
E shoh se leftër ngë jē, ne mund vish:  
mo i trëmburi këshill tas më buthëton

se ti si grāt më bën faqen mbë dish,  
e kūr mua sheh ndë pasetjār ndërron.  
Pse abonsina ndë ai, si taksën, ish,  
hajdhoje kët gjī kūr e helëmon.

5

tx: kurr

## 10. Këndëk e II

Ca do hēr kūr u pushōnj  
vjen ka gjumi të më zgjōnj  
ninza e vashës pjono zjarr

më e bukur se sā mëpara  
hēr haraksi, e me të lara  
faqe si harësh me bārr.

5

Ffirdritëm e ghavnare  
si e rē një monosare  
dukej si nga shkalla u hip

e një të ruar më dritsoi  
çë nga gjiu zëmrën rrëzoi  
me një spër harē çë jip.

10

Gjegja (o, mos ish e rreme!)  
se më thoj, gazëm, harēme,  
me ata sī dëlëgimzez:

15

"U për t'ij vart u lekosa  
sëmundës e u lavosa  
për namurin që më djeg,

e ndë shtrat gjith ambnōr  
ti prēhe i shkishēllōr,  
jo si molla rri ndē deg,

20 tx: shkishēllōr

gjithē trimbimes merēngome,  
bardhullore e verdhsome,  
me të bjēr mbē truall një prēs:

ashtu e vetēm u luftī  
kam ndē zēmēr pā armstī,  
ndē kta lipe e s' kē ti pjes.

25

U gjēllonj nga ti, e ghrēll,  
si ndē llak të vetme, thēll,  
kopile e bjērr vo rron.

30

Po me gjith se jep ti mua  
kēto vllepe, s' u harrua  
nga ti shpirti e të luton.

Se dishroi e se të deshi,  
se të ruati e se të qeshi,  
fare mendja u metanos;

35

vetēm dhēmbet e i spēlēqen  
se ti shkon e vete vjen  
e i buthētone posi gūr".

Kur kopilja kēto fjālē  
t' ēmbēla mē se ng' ēsht mjālē  
mua përpara rrīj e thoj,

40

i skotisur u dērsinja  
njēr që u nis e u dhe s' e dīnja  
qē të pērgjegjēsha i skallangūr.

45

## 11. Vjersh i VI

Dē t' ishja ndallanishe, sa një folē  
bēnja nd' at kamar ku, vajz, ti rrī.  
Se kūr të tirje finestrēs mbē hjē  
e vendet prej shkēlqije me ata sī,



u sipër të këndoja gjith harë 5  
një vjersh malli shūm t' ëmbëlë, të rī.  
Ni terjorisën, vash, pa vën rē  
dashurit [t]ënd të llargh varthur e zī!

12. Vjersh i VII

Popo, hjidhjore, kurmin gjith m' e grise;  
me sīt lotsōme ngaha mua dërgove  
fuqīt të prēra je ndë gjī skotise  
zēen e gjith këshillet fjturove. tx: kēsillet

Prana ngā zjarmi çë më diq hjimise 5  
e stepasī mē t' egëra e tharta vjove.  
Njera tek udha e varrit prā m' udhise  
e diruzēs vēdeke m' afrove.

13. Vjersh i VIII

Harakse ti si īll mbë dritēsōr  
e zēmrën sē m' e lē varthe ndë gjīr;  
ti hire pjono gaz mbrēnda, helēmōr  
u jasht qëndrova me të madh spjakhīr.

Me sī mē nēng të pē të bardhën dōr, 5  
moj me noēr të ruata më se mīr.  
Ndë mos më do mirfill po vēdekōr,  
krahēt jo mē, po faqet vet më prīr.

14. Vjersh i IX

U i njōm si ujt e ti e ngurēt si drū,  
u djeg si zjarmi e ti e ftohēt rrī;  
u për mallin buthtonem pā trū,  
ti gjith harē duke se amūr ngē dī.

U, kūr të shoh, qëndronj mbë vend si hū, 5  
e ti sison e më buthton mēri.  
Popo! se tas sēmunda ani m' arrū,  
kë sē shēron për mot jatro o jatrī.

15. Të përpjekurt

-- Më prore ti gjīn e pjot,  
më harakse sīn e zī;  
mori sprēsa tas m' u nxī

e helëmore pather thot: "Ngë të shëron më vasha, jo.	5
Iku moti çë të deshi, m' e dërgoi ndë t' llërgh zalle, s' e rrëmbenjën ata malle, me k' me namurī të qeshi, përse jetri ani ja e dha.	10
E kjo vet së kâ jamatos; s' e shëron mosnjë harë çë së vjen ngā ti; ndë kē lipisī, ju fanaros pjonoz gaz si luti e tha".	15
-- Mos më ngit se e jetri jam: dorën time jetëri i taksa, u kūr të pē tīj u trandaksa e së të desha po një pik. Mos më ngit, të thom, e ik.	20
Ndë me sī sīn tënd përpoqa o prej s' meje u fanaros faqja jote, zëmra u stros si të m' ish përpara thik, nga trëmbësia e të tha: ik!.	25

16. Vjersh i X

Kūr u dolla ndë dhë dielli perëndoi e me gjak faqen hënëza e nxiti; nga një ill porseksi e sa më pā mbuloi faqen mb' ohjistër, e një vorë çë friti	tx: hënësa
thajti ajo dhën e dushqevet u çoi fjetat e ndë një dejt të llërgh i shpiti. E faqen jeta gjith mbë lip ndërroi e nga ninula mëma ndruall më shtiti.	5

17. Këndëk e III

Kopile kuqullore, pra çë vëdekja mua më muar nga sīt e tua, më shtir ndo varr një lot.	tx: kuqullore
---	---------------

Mos u harro se hīt çë atje rrī gropsuar pjaxhīr mbë tjer ngë muar se tek ti e vetme vash.	5
Ahiena e gjithë e drethunë: "Këtu rrī i bukuri im" thua, po me sherëtim çë prier harën mbë lip.	10
Kī gūr i qet, i ftoht, faqen e bārdh mbulon e sishit fjuturon formadhin trim çë qe.	15
Sis ai lipisije, namurit kroi mburom, nderuar sa fare thom e ndonjerī ngë tha!	20
Ani, harruar nga gjith, lëshuar këtu pushon, e monu i bumblison ndër vesh kī thart vajtim!	
E kush prej nën e ndien, i ngār nga lipisia, harronet ngā hjidhia e klan me tīj atje.	25
E mua ndë vend ku jam kulëtima më gjellsonet e mallit, mbjatu e zgjonet prej tīj këshill-e i ngroht.	30
Ahier, e ngār mbë zëmër, ti lage me më lot, te zëa norea të thot: "Harēt çë shkuan kujto,	35
kūr përpara sīt [t]ënd, faqja ju bën e vërdh, si mborimje lot ju dërdh, e rrīje e ngūrt ti.	40
Ndë qeshe ndonjë hër, si ëndërr e kulëton: haraksur çë perëndon, se mbjatu së priret ajo".	

18. Vjersh i XI

Me gjith se së më ruan, un pather donja  
afër të t' rrīja tīj e nd' ato të zeza  
shkëlëqieme sī me nin time të luonja,  
e lutur më se lules po veza!

O zëe jo imja, tek ti ambnīn u çonja, 5  
e at këshet, ç' edhe s' e mbulon keza,  
me puth e grisnja e faqen; trashigonja  
pra dit e nat dëshirjes të dheza.

19. Vjersh i XII

U së mund të t' dua keq e tas të lë  
e vete atej mbān detit thēll.  
Ndë nat, mbë dit, kūr ecinj e kūr fjë,  
o afër jam edhe o shumë i llārgh,

tx: ārgh

o jam i mbār së ban'je o së bēnj u gjë 5  
o gjëndemi nd' ani shqerra pā vēll,  
noeronj sīvōn tēnde e ndë sa më  
strepe duronj ti jē imja gjēll.

20. Këndëk e IV

Ndallanishe, ndallanishe,  
pīre e thomse së më gjēn  
o më çon përmbjatu ndrishe  
ndēn dhē tas hīr i bēnē.  
Ti këndon, e Todhri më 5  
së t' ndīen, se ahīer s' ě.

Ti, mällmadhe, zäll e thēll  
se të shih'je më lëreve,  
tek pate të parën gjēll,  
tek u rrite e tek u leve. 10  
Moj ndë Todhrin prā do më,  
nëng e çon, se ahier ng' ě.

Moti lulevet kūr vjēn,  
kush e dī ndë thuash mbë tīj:  
"Popo! lulet nëng e gjē'n, 15 [= gjetin]  
kë rriti te kopsht-e i tīj!"  
Ti këndon, e Todhri më  
së t' gjegjēn, se nëng ě.

Pjono kallëz kūr ti sheh  
arat [t]ona verdhullore, 20  
zaen e Todhrit nëng e njeh  
mbi e të tjerëvet lartullore.  
Ti e kërkon përpara e më  
nëng e çon, se ahër ng' ë.

Kūr ndë vjesht kojllōrmet molla 25  
dimrin afër të buthtonjën,  
ato të verdha, kë u mbōlla,  
kam bes se më t' kujtonjën.  
Thua prā ahiena, ndallanishë:  
"Popo! Todhrin çova ndrishe!" 30

Kūr po gjithsh uratën mērr  
se të vesh te huaji dhē,  
zēmrën e ndien të shqërr,  
se ngë kân për t'ij më h'jē  
ka do sheh, o ndallanishë, 35  
sa pā Todhrin parū ë ndrishe.

#### 21. Vjersh i XIII

Dushqet hjesōr ndër llaka mua kujtonjën  
ato harēme dit çë shkuan e vān,  
e gjith spjakhīret ndë stomachj më zgjonjën  
kë vasha aharistose pather dhān

burrave të lekost; sā dishëronjën 5  
të mīra të dashur sfanmīr, ne kân;  
sa lot të bjērra e sā vinklla duronjën.  
E ng' aso rē një krua faqen më lān.

## [ R A P S O D H Ī T ]

1.

Vej i biri Fugh'jes  
rugh prë rugh ndë sij katund  
me ksulën prë mbi sī.  
Më shtëlloi nerënxjen,  
e m' i rā së bukurës 5  
ndër dōr e ndë llōrëzit,  
tek më rrij e terjorisij,  
afër pexherit, prë mbrënda  
të dritores ndë pëllas,  
ndë pëllas të Sklavunit. 10  
Moj e jëma, cila rrij  
e kumbisur qelqevet  
ndë një etër dritësore,  
kūr e bila u pataks,  
bë e bārdh ndë faqjet, 15  
e m' i rā gjejpërëza,  
ruojti jasht e trimin pa:  
"Raft dora, lumi trīm,  
çë m' i rē së bilës time  
ndër dōr e ndë llōrëzit!". 20  
"Mos e nēm ti, zonja mëm.  
Ai së pā e nëng fëtesi".  
Vasha ruojti trimëthin  
ndën sī e goj mbë gaz.

2.

ms: 1.

Mbaj e ëma të mbullir  
me trī veta shërbëtresha  
bilëzën të bukurëz  
ndë kastjelin të Sklavunit,  
mos t' e vrenej ndonjeri 5  
e t' i vrënej bukurin.  
Moj ji biri Fugh'jes  
bjejtī klīçe shurdhuriz  
e ndë natën t' errëtëz  
hapi derën të Sklavunit. 10  
Hiri thëll ndë kamarat

me linār ndë dorëzët.  
 Vodhi vazhëzën mbë shtrat  
 xhikarān, me linjëzën.  
 Duolli jasht, e mosnjeri 15  
 nëng e ndodhi e nëng e pā  
 mose zoga picëvërdh  
 çë këndonej ka menat ka] ms: kë  
 ndë një tup mbi marezën.  
 "Mori zoga picëvërdh, 20  
 mīr për tij, ndo s' e källëzon.  
 Dī ku stisën ti folën,  
 vete e më t' e shkallëmōnj;  
 ndo më dheksën, kūr kullosën,  
 vinj e më të përcilisinj 25  
 e m' e bënj mënitëzën".  
 Picëvërdha më s' këndoi.

### 3.

Trimi bīr ji Fugh'jes  
 me të bukurën mbë kāl  
 vej këtej, ikij atej  
 sheshevet e maleshit.  
 Mbi një mal i hōll e i lārt, 5  
 sa thëllëza s' mund e shkoj,  
 ndodhëtin një shatorë,  
 ç' ish je ngrëjtur Fatashit.  
 Fjetat in mundash të hōll  
 me t' rëgjënd illet e nats, 10  
 ahëta çë i frinej mbrënda  
 māl i mādhe e limonthī.  
 Hitin e më lodëjin  
 vasha e biri i Fugh'jes.  
 Sīshit me k' e fisnej trimi 15  
 dritësoi ajëri;  
 gazit çë m' i pririj vasha  
 lulëzoi kumbulla  
 e terjortur qiëllëzës  
 të së gjerës shatorë. 20  
 Shkundi lulet kumbulla:  
 kriet, llōrt e kurmërat  
 trimit zbardhi e vashjes.

### 4.

Kūr u pruortin Fatazit,  
 Fatazit e Dreqezat,  
 gjën shatorezën të zën.

Trimi fjëj e vashëza gjëm ji thëll e ëmbëlith: të qëlluor po qeshëjin. Fatazit e Dreqezat m' u rrëmbien harejes, mīr ato t' i bëjin shūm, keq këto sa dēt e lūm.	5     10
Mundi liga shkurqëzën e ndë gjëm i mbajtin nënd dit e di vjet. Pra mbë shpī nji herje njeri e jetëra më u gjën.	   15
Thoshin: "Nj' ëndër o një vërtet qe pësuoma çë më rā?". Një të diellën menat pra ndë qīsh u vrejtin e u njohtin e u lutin.	   20
Ruoj e jëma bilëzën mos t' e birij nj'etër hër. Te kjo, tek ajo pjes venej trimi se t' i flit, se t' i flit e t' e rrëmbej,	   25
njera ç' u përpoqëtin afër lumit i Sklavunit, ndë një vend i vetëmith. Trimi e zū e më e puthi, m' e puthi ndë goljet, m' e puthi ndë faqezit.	   30
Vasha gjith je nguqurez kallëti nd' uj fāqezën të më laj të puthurit, mos e jëma mūn t' e njih, po më nguqi ujthit.	   35
Kurëna nga hora aposhtaz duolltin grā të lain shqënd, mbër të zbardhëin, nguqëshin linjat çë atje po lajin; kopshtet çë potisëshin bëjin fjetazit të kuqe; zogezit çë pitin uj nguqulluon pendazit e më t' ëmbëj e dëlīr bëtin fërshëllimezën.	   40   45

5.

Ajo zoga picëvërdh  
më këndoi mbi <sup>marezën</sup>  
tek kopshti ji Sklavunit,



je porsir nga Fatazit.  
 Më këndoj e po çë thoj? 5  
 "Ku biu, ku biu nerënxa?  
 Biu ndë zall të dëtit.  
 Mosnjeri e kish kujdhes  
 mose bila e zonjës Lën,  
 ajo vasha Dhri je Bardh ...". 10

6.

Bëj këshill zonja Lën  
 vetëm po me tri bular  
 të martoin Dhrin të Bardh,  
 të m' i jipjin Qiparisin.

Dh. Qiparis ji hleshëmi, 5 ms: B.  
 çë petëk të jëp jot ëm?

Qip. Malin taksi pjonu kafsha,  
 taksi fushat shprishura  
 arashi të verdhullore,  
 sheshezit të pjonu lule, 10  
 kopështet të gjelbëra,  
 edhe dhromët me kangjele,  
 katër kuel të armatosur  
 me mundash e ërgjënd të holl,  
 katër mushka të nxelosëta, 15  
 të ngrakuora e me shatër.  
 Moj ti Dhri, o Dhri je Bardh,  
 çë stoli të jep jot ëm?

Dh. Një stoli çë taksi mëma: ms: D  
 nënd coha e nënd linja, 20  
 ari ato, bardha këto  
 më se bora e malevet,  
 me qindë mbërletashit;  
 nënd keza të vëluzta  
 të tërjörëmez me ar, 25  
 ar i tillqur penj' i holl,  
 pundeshi si koqe grur;  
 nënd sqepe gjerullor  
 liu i t' Indh'jes bardhullor;  
 nënd baule pjota shqënd, 30  
 nënd sënduqe me pajaca  
 të mundafsha, e po stoli;  
 nënd shtrete të pazën,  
 vet se shtrën e shatorën  
 tim shërbënj prë nusërin, 35  
 prë vet'hën e prë një shpë.

## 7.

Luonej vasha me një möll,  
vasha e bukur, Dhriza e Bårdh,  
prë harën kushqīs të bër  
me t' hjemadhin Qeperis,  
birin i të Fugh'jes. 5  
Shtij përpjel, e mblīdh ndë gjī  
tej këtej te kamara  
gjerullore, tue ghraxuor  
prapa mollës lārt e shtūr.  
Dha këpuca ndë rixhōll; 10  
poqi këmbën e u pruur  
prapa vasha mespurtek.  
Molla, çë së dij çë bëj, ms: su  
erdhi lartit e i rā  
ndë names të bardhit bāll, 15  
ballin nje m' i nxiti e sīn.  
Dha një thirm, rrjoth e jëma:  
"Qofç e bardh, bilëza ime!  
Kush të nxiti ballëthin?  
Kush të vrërți siuthin?" 20

## 8.

Venej trimi lumit lārt,  
venej zallit dal e dal ms: dul e  
tue xhatārtur e kërkoj  
diu se çë ndë zëmërēt.  
Foli atij një dallanische: 5  
"Ndo xhatrōn o mos ti, trim,  
edhe kët vit e nj'atër,  
dora pra të mbih'jet,  
gjuri më të lōdh'jet,  
duania pra të mbëshōn, 10  
gjella edhe të fluturōn".

T. E nga dī ti, mjera zoge,  
fatin të njeriut mbi dhē,  
nd' është i bārdh o nd' është i zī? ms: njeriu

D. Fluturōnj u ngjīllëshit 15  
e dreposht po shoh e llārgħ.

T. E çë pē të fatit tim?

D. Pē një māl të gjër e lārt, ms: N.

çë njeri s' und e kaptoj  
 po se vetëm dallanisha, 20  
 cila vej ndë një tër dhë.  
 Qeni turk e shkeli e shkoi,  
 shkeli e shkoi e [e] bëri shesh.

Dallanisha fluturoi,  
 [fluturoi e] as foli më. 25

9.

Prirë trimi ji hejmuor,  
 tue penxuar fatin e tij,  
 më të dheut tek u lë.  
 Ndodhi zogën picëverd.

"Mos më shkreh, o bardhi trim,  
 se vëndurën më të thōm". 5

Ndënji trimi nd' at vend.

"Flit, o zog, se marr vesh".

"Ndallanishën e porsiti  
 Dreqeza ndë llak të thëll, 10

tek, e zënur ndë një lak,

rrij t' i dridhij xerkuthin,

mos ngë vij po të të thoj

di të rreme e një vërtet,

cila as bëhet me di vjet. 15

Mua më zuri Fatëza

mbi një rahj ndë t' ëmbëj ulli.

Parkalesa të më lëj:

më lëshoi e më lëreu,

moj ndë sī më paraste 20

fatin e të dheut tënd.

Qiparisi e Dhriza e Bārdh

bënjini bij të fōrt e shūm,

cilët malet bënjini sheshe,

sheshet i përllaknjini, 25

luonjini fōrt mahjerezën,

lënxën e dufekjen

kundër Turkut, cili vjën

nd' atë shesh të hapurith,

ku m' u bī koqeja pjeshk. 30

Pjak ti bër ahiera,

vete [e] vjën ka Venetia,

ku ndë bulari kërkon

ār e ndihëm, e ndë gjëri

vetëm e çōn, e pjeshkëzën 35

prë ca mot e ruon, e mbjēdh

pemazit, e ndën asaj

ms: zëri

ms: sheh

prëhe e më pushōn mbë hjë.  
Pra vëdes ndë njetër dhë".

10.

Fërshëlluon di zoge,  
një atej, një përkëtej;  
foli e njera jetërës ...

Deve stare in quinto  
luogo, che varrà poi di legamento  
all'altra di Allibek, il quale aveala  
chiesta a sposa e non la si ebbe, e  
nella pretesa di rapirla viene ucciso  
dal fratello di Ciparisso, f[iglio] di  
Fughe, cognato di Biancavite.

11.

Dalur dielli maleshit,  
më mbjoi di pëllese.  
Më i shkepti zonjës Lën,  
tek së bilës mbi thronit,  
cōh gjith lule āri,  
ish e i pjeksënej këshën  
e mbi shīr ja mblidhij posht;  
shkepti nd' at mot edhe  
ndë pëllas të Fugh'jes,  
tek prë ndaj pasqirjen  
zonja Aghat shtuora  
më stolis birin e saj  
me vëlus e hrisonëm;  
po të skamallisëshin  
skamallisshin e këngoin,  
si po dhëndërra të krështë,  
ndë qishën të Thodhërit ...

5

10

15

ms: vëlës

Dietro questa canzone si pone  
il carne nuzziale, quindi il canto  
"Kush m' e bëri triesën ...", poscia  
l'altro augurale sull'effetto del  
matrimonio "Mori vash, je bardha  
vash ..." 64. Dappoi i lavori domestici,  
cui si adatta Biancavite, e il suo  
ricamo "Malet e Pjetër Shtërorit"  
modificata 18; in prosiegua la prima  
avventura del nuoto di Ciparisso,  
"Gjith suvala i nxuori mb' ān" 22.

Seconda avventura. "Vū ngusht trimi fanëmīr ..." 39. Il presentim[ent]o malinconico. "Vjën Marsi, mīr se vjën", 37. Canto I, P. 69. Gara di Biancavite con la cognata. 69. Una canzone da farsi sull'ampia prolificaz[ion]e di Ciparisso e Biancavite. Tentato rapi[mento]. Morte di Ciparisso, ferito da Turchi, che tentano le prime scorrerie. Figli di Biancavite: Didescura, Pietrostrori, Radavano e Miloscino. "Ajo zonja Dhriza ..." 79. Tentato rapim[ent]o di Biancavite per opera di Allibek. 23. "Bëri këshill Allibeku". "Vej i bīri i Fugh'jes" 1. "Mbaj ..." 2. "Trimi ..." 3, "Kūr ..." 4, "Ajo zoga" 5, "Bëj" 5, "Luoj" 6. "Venej ..." 7, "Prirej ..." 8, "Fërshëlluon di ..." 9. "Dalër ..." 10. Carme 11, "Kush" 12. "Mori ..." 13. "Malet ..." 14, "Gjith" 15, "Vū" 16, "Vjën" 17, "Ligjërojin ..." 18, "Ajo ..." 19. 20. "Bëj ...".

16.

"Vjën Marsi, mīr se vjën!"  
 më këndonej Qepirisi  
 mbi një rahj te kopshti tij.  
 "Marsi vjën e mīr se vjën,  
 vjën i but e i tharëtith, 5  
 ture shtunur shī me diell.  
 Fushazit i lulëzōn,  
 malërat i mjegullōn,  
 dritën e harën përsiell  
 daskalvet, skollelëvet, 10  
 cilët xë e po mbësonj[in]  
 ndrishe shorta ghramatī,  
 cilët dhjvasën e xën ms: zën  
 monoshtireshit të vrërt.  
 Dit prë dit më shkonjin 15  
 ajrit llojë gorrile,  
 cilat drej e fluturonjin  
 si suvalat jetjes.  
 Mori zonja ndallanishe,  
 cila vete jasht e vjën 20  
 e më luon mb' atë dhokār,  
 ndo kë ndonj llajim prë mua,  
 thuame e zëmërën më shkrif".  
 "O jalimono ti, trim,  
 çë më pīen e do të xësh? 25

Lajmit çë u të siell  
 jân harëme këtu jasht,  
 teku dëti mbaru mbaru  
 më u shkri e butësua.  
 Moj përthëll ndë zëmëra, 30  
 ndë pëllese e nd' ato shpī  
 kush e dī çë sheh'jet,  
 kush e dī çë fati shkruon  
 bardh o zī mbi gjelljen?  
 Dielli shkon e malet nxinjin, 35  
 nata arrën, e pjakënia  
 lufëtōn me deqjen".

17.

Ligjërojin di kunata  
 anamesa ca gjitone,  
 të di rea t' Aghatës,  
 të martuome ka trī vjet.  
 Thoj e para, Dhriza e Bardh: 5  
 "Jām e mīr më u se ti.  
 Kām anaka t' arëtaç,  
 kural' e margharitare  
 vëlus e mundashëra  
 ndër sënduqe, e kamarvet 10  
 kām kriate çë më gjegjënjin,  
 gjith çë m' i dha zot' im,  
 zoti jīm e zonja mëm".  
 "Më e lūm jām u se ti"  
 thonej jetëra kunat, 15  
 bardha bil je Misistratit.  
 "Kām prë sqep qiellin me ilëz,  
 keza ime dielli,  
 kām për cōh detin,  
 imi thrōn ẽ jeta e gjër, 20  
 tek rri zgjuat e, si dua, fjẽ".  
 U pruar mbë të qeshur zonja  
 Dhriz e Bardh e thoj papā:  
 "Po sa e fānëm jām u vet!  
 Kām te djepi djāl të pār, 25  
 çë, kūr qeshën e kūr qān,  
 mua zëmërën më ndān".  
 "Dhe u kām një vashez,  
 çë frimōn si nj' ẽngjëllith;  
 kā të ruomith ç' ẽ harë. 30  
 Nd' ajo qeshën, më gëzōn  
 fān, e mallin më rrëmbën,  
 e, ndo pak të zaljet,  
 shpirtin dreç m' e fjuturōn.

Çë të jët, je bër kopile?". 35  
"Zëmrën merr të birit tīm!"  
u përgjegj zonja norë.

18.

Ndë didhjet shkuora vjet  
ajo bila e Misistratit,  
je qëndruor e vetëmez,  
ndë të bilëzën kopile  
gjër kumbisi një spërën. 5  
Dhidheshkura, i pari bër  
të së lumes Dhrī je Bardh,  
ish ji doq e, bënur trīm,  
e lutoj të bukurën  
kushërīn me zëmërën. 10  
Bëñ kushqīn e dasëmit,  
u martuon e u pëzien  
bardhi hjil' i sheshevet,  
monosaqja e tupevet.

ms: bẽ

19.

Ku biu, ku biu nerënxa?  
Biu ndë zāl të detit,  
anamesa ndë di rehje,  
ndë një llak e vetëmez.  
Mosnjerī kujdhes i kish. 5  
Vetēm pjaku zoti lal,  
zoti lal kuqekësul,  
vinej për menatje,  
m' e tagjisnej e potisnej,  
me koprë je rethullonej, 10  
e qëroj e sfilighrosij  
gjëmbashit e degashit  
të papema, e ruoj e prana  
vëhej ndān të m' e këndoj:  
"Rritmu ti e madhëmu ti, 15  
rritmu ti, nerënxa ime,  
shpiju lārt e lārt njëhere,  
dega shtij të dërrudhjare,  
mbashk me lulet pemazit  
ka një vit te jetëri". 20  
"Hjezën bëm të ndëndërez,  
të fëtohtez e të gjere,  
për bulār e bularështa!"  
Sa je vogël ish nerënxa,  
keq të madhe bëri hjën, 25

teku triesën të gjër di fëmija bujarishte shtruon e gjith anxëitin, kūr i pjaku zoti lal, zoti lal kuqekësul,	30	
desh t' martoj të mbesazit, Dhrizën e Bardh të Kastriotit, Torezën të Misistratit. Ishin zotra e zonja shūm mbi palaca të mundafsha.	35	
Rrotull rrijin shërbëtōr, por me shapëkat mbë dōr; shërbëtreshat keshtavet kishin pema t' ëmbëlaz, e shatërt qitharat ngitëjin me armonī.	40	
Ture ngrën e ture pīr, nga zot mahjeren mbrez, nga zonj te krahu i saj një të bilëzën kopile	45	
e mbë dōr një djal i bukur. Nga kopile kish nj' unaz, ka djal një nerën, dhënëme të nusjes.		ms: kopil
Ardhur, ahta e dētīt tundij fjetazit e sqepet.	50	

20.

Allibeku i Rromanīs xuri se prë nd' Arbëri ishin bardha e kuqullore, mirudhira trondofile. Dhriza e Bardh të Kastrjotit, Toreza je Misistratit	5	ms: xëri
ndër të tjera shūm e shūm kishin ëmër më të lārt. Allibeku Torezën lipi nuse e nëng e pati:	10	
duoj e jëma, s' desh' i jati. Allibeku, thëll e fōrt i mëritur, zuri bē të rrëmbenej Torezën, kūr të vinej dita e tij.	15	ms: zëri

21.

Fërshëllojin di zoge.



Gjith suvala nxuor ndë zäll trimat, që luojin ndë nõt posht te dëti Spexjes i Sklavunit, ndë një dit verje. Vetëm Qiparisin mbrënda	5	ms: dëthitin
e dëthiti e më thëll, trimin i së Bardhës Dhrī; e atë vetëm së nxuortin shokët, kūr u adunärtin gjith e mbë një gol thërritin: "Fän i keq, ti mbitje!". Tek po gjegji e bukura, cila llarghu i vënej rë, u ngre, keq bënur e bårdh, ture lidhur skemandil.	10 15	
Erdhi jasht e nd' uj u shtū. Ja e arrū trimit i saj e je nxuor te zalli jasht bukur e shëndoshëmith.		ms: shëndoshëmith
"Se ti, trīm, fanesëmi trīm, cili gjū më t' u përgjū, cili krah më t' u mbī, cila dōr së të shërbeu ndë pirikulin që shkove?	20	
T. "Mua jo krahu më u lodh, mëngu gjuri m' u përgjū e jo dora më u mbī, moj desha të njihënja vetmën të shokëvet".	25	
Hojqi e thjëll zonja te shura me për dorje zōn e saj. Shokëzit të turpurith tu këtje u shehëtin, moj dica të rremëtār bëjin të hejmuorith prë pësuomen e të shokut.	30 35	

Ndë podhën të malevet të Qeravnit, që ndë çuka semre rrīn ngrakuome bōr e më ndën mjegull e shī kān ka një te jetëri vit,	5	
---	---	--

zonja Lën të Kastriotit kish të stisur një kështjël höll e i lart, sa mjegulla ngitij qeramidhezit.	
Mjegulla stisi folën e folea çë stisënej ish e piksur driza āri; vēt prana çë më bëri īn fllurome t' arëta;	10
zoget pra çë nxori vëshit duallëtin me lafshe t' ārt e me krahzit të rëgjënd.	15
Kūr kënduon ata zogj, era, çë shkonej ndë fjetat lisëvet e pjepevet, më qëndroi e gjegjënej të kënduor ngjiellshit, t' ëmbëlōr e keq t' ëndëm, aq sa prëhej e mirr vesh	20
Bardha Dhri e Kastriotit, nd' at hër çë rrij e pjeksënej shtruome katër faqeshi. Zonja tek e para faqe më qindisi zōn e saj me të gjith shater mbān.	25
Prana tek e dita faqe më qindisi vetëhën me arrotulla krietet.	30
Ajo tek e treta faqe më qindisi diellin m' aq rrëmbazit e tij. Po tek e katërta faqe më qindisi hënëzën, bardhezën si bilazit çë më kish ajo ndë pllas; e, si hëna perëndesh, je rrjedhur ilëzish, i buftōn për mbrëmanet ndë katunde e nd' ato hora shprishura ndë gjeren jēt, rrij ajo në mest atire.	35
Nën m' i rrethti mjegullën ngana hapjin krahezit ata zogj çë nxori vëshit, cilët e ëmbël po këndojin mbë vërtet nga qiella e hareje shpīt i mbjojin.	40
	45
	50

Vuri ngusht Qiparisi,  
 vuri ngusht po me një Turk,  
 cili vej tuke levduor  
 horashit, katundeshit  
 se së gjëndeje për mbi dhë 5  
 një'tër kal si murxhari,  
 që më kish se vetëm ai.  
 Ngushtën vùn e patin bën  
 të rrëjidhëin kuelët bashk.  
 Turku vū Turkeshezën, 10  
 trimi vū të bukurën.  
 Mori zonja kūr e xū,  
 sīzit ju ngarkuon lot,  
 tue penxuor se zot' i saj  
 me një Turkeshe e parparosij. 15  
 Muori liçezit ndë dōr,  
 vū panarezën mbë llōr,  
 elëp e pjot e mel e vēr  
 e m' u zdrep ndë staljet,  
 drej rrjodh te murxhari. 20

Z. Mori ti, murxhari jīn,  
 nesër ndë lughadh të gjat  
 ndër e madhe të më bësh,  
 ndër e mua e zotit tīm. 25  
 Ndër sēnduqezit e mī  
 kām u breze të rēgjënd,  
 ndēnbarken të t' bēnj;  
 kām u cōh të vëluzta,  
 paravithet tij të bēnj.  
 Ndër sēnduqezit e mī 30  
 kām anaka perlash,  
 kām unaza t' arēta:  
 frentin tij e murxhēzën  
 t' e dērtōnj e bukurōnj.  
 Mori ti, murxhari jīn, 35  
 nesër te lughadhi i gjēr  
 ndër e madhe të na bësh,  
 po si mua dhe zotit tīm".

Hingulisi murxhari.  
 Si m' u dī menatja, 40  
 vān te lughadh' i gjēr  
 e rrjodhën kuelët bashk  
 anamesa ndë bulēr,  
 trima, vasha e ndrisha gjind,  
 që me zēe mbë llaftarī 45  
 ruojin ngjiell e truhëshin.

Po sa kali i qenit Turk nisi dreq e pjono fōr e ndë vet një shkurtur koh shtat qind rrade thieu.	50	
Mori kali i Qiparisit prë diqind përpara e shkoi e ghavnjeu zotit i tij nderën e Turkeshezën.		
Ndënji zonja Bardhe Dhri tuke pritur aso dit ndë dritore e nd'ato dier, e më ruonej diellin.	55	
Pra çë dielli perëndoi, muori zonja drapërin e m'u mbosht ndë perivōl.	60	
Kuarti mose trondofile, monosaqe e rrodhostane, bardha hjile e tjera lule për shtërān të zotit saj.	65	
Vū për kreu trondofile, vū ndë mest rrodhostanet, vū për këmb monosaqet.		
Prana u vū me tjera lule të më pjeksej di kurōr, e një thik mbanej ndë dōr.	70	
Njota e hingëli murxhari, hingëli murxhari proposh, te kurtili ndë pëllas.		
U pataks zonja e rrjodhi vrap sa më pë shkallazit: kup vër qellij ndë dōr, kufën elpi kish ndë llōr.	75	
Kupën ja e ndëjti zotit, kufën ja mbërpārti kalit.	80	
"Po na rruoft murxhari e më zoti, cili e shpiti të rrëjdh si erezal!".		
Z. Njota, zonj je mira ime, solla tij Turkeshezën	85	ms: xorrobijt
të të tundinj corrobijt kūr i mbān ndë ninulat, të na ndreqinj kamarat, të na shtrōnj triesën, të pastrōnj shtretezit, të na krehinj vashëzat.	90	

1. "Vej i biri i Fugh'jes". 2 "Mbaj të mblitur zonja Lën"; 3 "Trimi bër ji Fugh'jes". 4 "Kūr u pruortin Fatazit", 5, "Ajo zoga picëverdh". 6. "Allibeku i Rromanis" 7. "Bëj këshill zonja Lën / me bulër sa kish gjëri". 8. "Luonej vasha me një mōll", 9. "Venej trimi lumit lart", 10, "Prirej trimi ji hejmuor", 11, "Fërshëlluon di zoge". 12, "Dalur dielli maleshit". 13. "Ligjërojin di kunata". 14, "Gjith suvala nxuor ndë zall". 15, "Ndë didhjet e di vjet". 16. "Vuri ngusht Qiparisi". 17. "Bëj vuli Allibeku". 18. "Ajo zonja Bardhe Dhri". 19. "Treti bër ji Qiparisit / më udhisi nënd trima", 20. "Marsi vjën, mër se vjën". 21. "Ulu, nuse, e lumja nuse" + "Mori vash, e bardha vash" + 22. Carme nuzziale. 23. "Kush e bëri triesën", 24, "Kūr u jesh i vogëlith" da stare in primo luogo qual espressione generale di un popolo libero e selvaggio. 25. "Vasha marr të hollazit", secondo luogo. 26. "Kūr leve, leve ti, vash". terzo luogo.

27.

Dimbëdhjet vajza  
gjith më kishin një këshill  
e, të mbledhura mbë vend,  
stisët in një monoshër.

51. 4

Se ti, vashëza hajdhjare,  
je shëndoshëm e dëlir,  
je përveshure mbë llor,  
nguqure ndë faqjet,  
çë më gjuhën ata brum,  
gjeshe fōrt e ngure shum,  
bëj kuleçe dhëndërrash,  
bëj kaliqe nuseshi,  
bëj fukaca pjeqëvet,  
bëj kravele trimavet,  
bëj llaghane e bukëvale  
të ja sheç lëtinjëvet,  
qull e prë të huojit,  
krunden jipja Turqëvet.

5

10

[A]

Frinej nj' ajër, nj' ajërith,  
frij i hōll, i dredhurith;  
leth më hapi derjen  
të së kamares, ku rrij  
djali vet ndë ninulët 5  
e pushoj e qeshënej  
ndë një gjëm i ëngjëllisht:  
ish ji vogëli Kostondin,  
bīr ji prasëm i zonjes  
Bardhe Dhrī të Kastriotit. 10  
Tundi ajëri ninulën  
e më zgjoi kërddhiuthin.  
Thirmashit bumbllisënej  
plassi gjith e kamarat.  
Nje rrangoi Turkesheza, 15  
nikoqire çë m' e ruoj.  
"Qetu, qetu, biri jīm!  
Vallja u shqit e vjën jot' ëm,  
e, si gjëndet e stolisur,  
anakosëme e unazisur 20  
e me lulezit ndë xerk,  
sis të jep e të qëllōn.  
Ti së qān, e ajo këndon  
e të bēn aghurëthin  
fanëmīr e të hajdhjār". 25  
Nd' at njëmend hiri ndë shpī  
Bardha Dhrī, e kamarat  
veshëtin një drit e rē.

[B]

Iku vasha e muori malet,  
vetëmez me vetëhën,  
tuke qār e tuke u shqerr.  
Qeni Turk ç' e kish rrëmbier,  
adunartur se i shpëtoi, 5  
nisi vrap, e pas asaj  
vej me kal të m' e rrëvoj.

74.

delle prime, dopo le nozze di  
Biancavite.

Vash, ndo do të duhemi ...

Rān ca Turq e ku më rān?  
 Të zdrepur galëshit,  
 ndë ca vende afër detit.  
 "Bëre gjë te mali, shok?  
 Ç' i rrëmbeve Turqëvet?". 5  
 "Ndë Turqī së vajta,  
 ato dhera ng' i kërkova.  
 Moj ca Turq u i përpoqa  
 ndë nj' llakat, çë prirëshin  
 të ngrakuor ka dheu īn. 10  
 Katër dele e katër dhī,  
 katër lopa e katër qē  
 me di dema je di viçe  
 kishin marr e një kopile  
 kuqullore e bardhesī, 15  
 cila klanej me hjidhī.  
 Me kaloqen u ju hjodha,  
 dive i shtipa hënëzën,  
 hënëzën e kriethit;  
 tjert u dhān këmbëshit. 20  
 Mbjodha predhën e m' u prora.  
 Qella vashën s' ëmjes  
 me stolit e Turqëvet,  
 jetrën pjes prë vetëhën,  
 si më ngit, e mbajta". 25  
 "Je vërteta gjaku īn,  
 ëmër e bëme arbëresh!".

[C]

Si ait tek ajëri.

[D]

Pienej jati bilëzit:  
 "Sõt ç' ë dita e Shën Mëris  
 brodhtit gjith prë ndë katund.  
 Mirën o të ligëzën  
 suolltit ju ndë ngushëtat?". 5  
 1. "Munda u ndë rrolet,  
 se me vet një kopanë  
 zallin shkova e shurëzën,  
 e te dejeti vate hiri  
 e m' u zbūor rrolja". 10  
 "Pafç uratën, biri jīm:  
 mundën Turqit me më hjë".

2. "Ndë të ditën kopanë me dufekëzën të rë, çë më suoll ka Venetia zoti lal e lalëresha, ndajta aradhën prë ndë mest. Mosnjeri së shkrehu më ndë sa burra in ndë vend". "Pafç uratën edhe ti, bīr! Kūr nd' amahj të gjëndjesh kundër Turqëvet, ja ruoj dreq ndë bāl Pashajvet".	15	v. e.: e jemëta
3. "Bëtim luften e ndë pes trī m' i shtura shurjes. Vetëm i bīr' i Fugh'jes mīr më lodhi e së më shtū, se u mbajta fōrt e dreq shtuora më se jo një hū. Pra më lëreu, tuke mallkūor vetëhën e tue bekūor mëmën e ātin çë më lēn". "Qofç' i bardh, o biri jīm! Kūr të jësh ndë lufëtet mushkomënde, mos u humb mëngu drej të madhit Zot, moj si lis e qeperis kundërsto me ajrat".	20	ms: bërra
4. "U ndë t' ikurit i shkova katër trima, ç' in përpara prë tri rrade, e nëng arvova tek aradha të rrëmbenja shabjen e mahjerezën, se names të rrjodhurit shkava e këmbën strambuliksa. Plaku judhëç' i Çetjes mosnjeriu për atë hēr desh të jipij dhënëmen. Vogëli bīr i Fugh'jes, prasëma qot kjo fanī!". "Paq e mīr, o biri jīm! Sodepār të fluturōsh si shëndoshëmi sqapār, çë rrëmbën tek ajri miza, bjeta e pallarē. E ti, bij, çë bëre sod prë ndë valle e lodhëra?". "Luojta mīr e mīr këndova, dheza malle trimavet, zgjova mbidhje vashavet, shtrëmbur ruojin plakzat, djelëmat me thavmasī,	25	
	30	
	35	ms: hëmb
	40	
	45	
	50	
	55	
	60	



burrat bëjin shëng me sī".  
 "Qofç e zeshk, o bila ime,  
 ushtra e tēt vëllezërvet!".

ms: e zesh

65

### C a n t o

[E]

Shkepti dielli nd' ato male  
 mbi bōrën strabardhjez.  
 Rrëmbi prjerrur dha ndë bāll  
 t' ungëlit të Fugh'jes,  
 çë stolisij Rradhavān.  
 Je stolis e i vëj kurōr  
 se t' e mbashkij Torezës,  
 Torezës të Misistratit.

5

ms: Torezëz

[F]

"Se ti, bīr e biri jīm,"  
 - thonej Aghata një dit  
 Qiparisit i ndërruor -  
 "çë sëmund ndë zëe më kē,  
 cili māl më të hejmōn?".  
 "Mëma ime e dashurez,  
 diu çë pē e nëng pē,  
 diu çë ngava e nëng e ngava.  
 Pe një zog çë fluturoj,  
 bukur më se ilëzit;  
 pē një lule, cila flitij,  
 flitij e më falënej.  
 M' iku zogu duorshit,  
 m' iku lulja gjishtëshit!  
 E kërkova nat e dit  
 prë një mot e prë një vit.  
 Zogun ndodha e lulezën  
 prë së riu, po s' mund e marr,  
 pëse dora së m' rrëvōn".  
 "Mos u trëmb, mos u hejmo,  
 biri jīm i dashuri.  
 Teku dora nëng arvōn  
 vete ligja e më kërkōn".  
 E dërgoi një proksenit  
 zonjës Lën të Kastriotit,  
 një bujār së pārëshit  
 t' asaj hōr t' i lipënej  
 Bardhen Dhri prë Qiparisin.  
 Zonja gjegji e ju përgjegj  
 se, mos pār të mirr vuli

5

10

15

20

25

30

me të sajën bujëri,  
s' mūn të zgjīdh o lidhij gjē  
prē të bijzēn të saj.

Canto

[G]

Vogēli bīr i Fugh'jes,  
pak me trū mbē vetēhēn,  
mē udhisi nēnd trima  
ka mē doqit prē ndē shok  
se të vejīn të rrēmbejin 5  
nj'etēr aq bukura vasha  
ndē lētīnj të Rromanjīs.  
Udhjes ngaha mē vān  
ju pērpoq një burr i pjak.  
"Pafçi mīr, të lumēt trima! 10 ms: të lēmēt  
Vīnj edhe u pjak me jū? ...

Canto

[H]

Vash sīzez e mespurtek,  
bukurushez e ghavnare,  
çē mē gjeshēn ata brūm,  
gjeshe mīr e ngure shūm.  
Bēj të gjere petēzēn, 5  
sa të marr furrin je vet;  
rregjīn bēj me rregjērēsh  
e lughadhīn me suldet;  
bēj pushtjerin po si ēsht  
i pushtuor me arazit; 10 ms: bējīn  
kllosēn bēj me polloqīdhe,  
dosēn bēj me rikazit,  
mēndērat me kavēsh e dhēn,  
kuel e pela sa të jēn;  
horēn e qīshēn me këmbōr 15  
e me flamur lartullōr,  
e katundit, ka ti jē,  
jipi mē se mundēn hjē.  
Pllasin bēj pjonō bulēr  
me ndē mes vatren të gjēr; 20  
treghun bēji me markat,  
mbjo me gjīnd udhēn të gjat;  
perivolet pemullōr  
nd' at ahjīmaz gjerullōr. ms: gjepemullōr

Canto

[I]

Ndë një dit je verje vapa tundij ajërin, fört këndojin cinxërrat. Qiparisi e shūm të tjër vān mbë dēt të lagëshin,	5	
të më lajin kurmërat, të m' i lajin e fëtoh'jin. Sqepëtoin prë mbi dēt shtat galē, si qifëti fluturōn tek ajri.	10	
Jin kusār të mushkomënd. Vān e vān e ku më rān? Rān ndë dhē të albëresh, ku ca vasha bujaresha mbrēnda ndë një perivol	15	
më qërojın majorān, petroselen e xafarān. Më u hjo dhën e më rrëmbien shtat kopile e një djal. Ishin bila e Marqanoit,	20	
shoqeza e Nik Pets, bileza e Gharadinit, drita e sīvet të së jātit, motëra e t' Radhavanit, mbesa je Pjetër Shtërorit,	25	
mbesa je të Dedi Skurës, bila edhe të Lopësatit, biri i të Rrodhotait.		ms: birin
Gharadini, murgu burr, më u vësh mbë këllogjar ... 101.	30	

42.

Më udhisi Arminoi, më udhisi ortën e tij. Hiri thëll ndë Arbēnī e sa ndodhij vrit e mirr.		ms: mīr
Ndodhi vetēm Rradhavān ndë një mal i llargh e thëll, teku vate të xhatroj: më je vrān e kriet i prën, po më shok të shtruor lërien.	5	
Më perndoi dielli prë trī hēr e nëng u pā. Ajo murg je shoqja,	10	

kūr u pā je vetëmez, nisi, e shkret e je rrëmaksëm, të kërkonej zōn e saj.	15	
Pas trī dit të dekurith më e gjeti e krieprër. Më e mbjodhi ndë një thas e t' ngrakuor e qellij ngrah.	20	
Tek rrëvoi ndë një përrua, më u prë të mirrij frīm e të lagij goljen nd' uje të fëtohëta. Shkuon ca ushtrōr atej, vashën pān e liptin uj:	25	ms: Ume
"Ëme, vash, një pik uj". "S' kām ku t' e jap u, trīm". "Ndë duor tënde bardhullore". "Dora ime pjot unaza pikën uj nëng e mbān".	30	ms: sosë
"Vetëm pikëza çë mbān mua më sosën e mbarōn e më shuon zëmërën". "Trim, sē dī me kë ti fjet. Ndëç' u zgjoçça burrin tīm, gjith sa jini copa copa më ju bën e thela thela".	35	
"Kush më është kī burri jit?". "Radhavani, ndo ng' e dini!". "Qofçim truor, o zonj' e mīr!. Mos e zgjo prë një'tër cop, sa të shkonjëmi këtë mal, këtë mal e jetërin".	40	
"Radhavān, përdashur' īm, nd' i vëdekur i tramaksën, shih çë bëre kūr i gjāl ngrah u hjodhe armiqëvet!".	45	

[ ]

Shoqja je Dedi Skurës, je qëndruome kolloghrē ndë më mīr të gjelljes, s' und përpij e qēt mbë paq deqen të sēmadhit shok, e porsij të birëthin tet vjeçi e i varfërith, e porsij e po i thoj: "Rritmu, bīr, e rritu i doq, mund mahjeren të tit ati, e po vet me një ghraxim	5	
	10	

kalin ngjite, çë të la.  
 Kudo jān armiqt' e tij,  
 m' i kërko e ji lavos,  
 si tēt' āt lavosētīn, 15  
 e lavosētīn e t' e vrān".  
 Prana murga nojtesh ...

[K]

"... o të xësh sa ille jān  
 prë ndë qiell, e po si vete  
 ç' ecënjin e nëng qëndronjin  
 ndonj hër tek udha e gjat,  
 çë ndë pjazëme i shënoi 5  
 stoneonëmi Perend;  
 o të dīsh sa shpirtogjēll  
 shprishura këtu këtje  
 dheu mbān e dejeti;  
 o të fjāç njīnje njīnje 10  
 gjuhën tēnde e mīr të thuaç  
 tjerëvet çë kē ndë zëe  
 pa u babartur e dēlīr".  
 "Zoti dhaskal, çë më thua?  
 Njotani çë dua të xē:  
 dua fuqī ndë llōr e dōr,  
 doqērī ndë kurmin gjith,  
 kuel të mundinj e kalonj,  
 dua mahjere se t' i luonj  
 me fuqī e vrundullīm 20  
 sa të presën ndë një hēr  
 sa di krah një deg je trash  
 riqje o ilēku.  
 Këtje posht gjēllīn një zot  
 anamesa nd' ushtērōr 25  
 të mixōr, çë atin fīm  
 m' e lakosētīn e m' e vrān".

ms: ndë hēr

[L]

Gjergj Kandreva (cili thuhej  
 se lodroj me Fatazit,  
 e ca tjer thojin edhe  
 se m' e lidhētīn Drequezat)  
 kish te krahu aq fuqī 5  
 sa të luonej një mahjere,  
 çë s' e tundjin e s' e mundjin  
 me të katëra po di vet.  
 Çanej petikōnj me duor

si të njomëza kalique 10  
e këputij një tërkuz  
dellëshi, si t' ish një pë.  
Prë di muoj shihej ndë hōr,  
nj'etër di së dukej fare.  
Gjergj Kandreva shkoj një dit 15  
vet e me frëshër mbë dōr  
ka një rugh je ngushëtez.  
Bukur ish ndë sa të bukur  
gjëndëshin tek ai dhë.  
Gjith e ruojin me cjudhī 20  
trimazit e vajzat.  
Ndodhi nd' at rugh një bardhe  
sī-je-zez bukur kopile,  
kuji me frushër i ngau  
kriet e këshetëthin. 25  
Vasha e nguqurez qëndroi,  
si je ngritur, nd' at vend.  
Jëma, cila më e pā,  
duoll ka parahirja  
e më tha trimit i rī: 30  
"Trim, çë ngave timen bil,  
së dī ti se kush më nget  
një kopile ka t' e marr  
pra prë grua, daft o jo?".

[M]

Vasha, kūr çë xū të zōn,  
zōn e saj të dashurith,  
të ngapuor ndë filaqī,  
u hejmua e rā mbë lip.  
Një e di, trī muoj e priti. 5  
Kūr më pā se nëng i vij,  
me vetëhën bëri vulī  
po të vej të m' e kërkoj.  
Më limothi kriethit,  
mbjodhi pāl këshetëthin 10  
me prialësin të vërdh  
të shkëllqēm si ār i hōll;  
vëthezet më vū ndë vesh,  
vuri anakazit ndë qaf,  
me xhipunin të vëluz 15  
mbi vo linjözën të bārdh  
dhja si bōr njëmend e rār;  
mbi zilōn të kuqullore  
e mbi coh të gjelbëröz  
ngjeshi mesin të purtek 20  
me një brez ërgjëndullōr,

[ Po se t' ikij shehura  
[ E mbë duor të Turqëvet  
[ ndë harën të gjithëvet  
[ ajo vet me shumë hjidhī  
ms: vëlöz

gjith me ar i terjorir; veshi e mbathi kembezit kallucjeteshi mundashta e kepucat me kaliqe.	25	
Pra unazen e besjes vu nde gjisht, e lez e qet nisi e vate ku te vej. Çajti bor njera nde brez, qaterin njera mbë gju, prapa len malet e saj; lume shkoi, perronje e llaka.	30	ms: lëme
Jarin çoi nde filaqi. Filaqerit, kur e pan drej lart kanxheleshit, gjith e ruojin me cjudhi. Hapi deren strazetari e m' e vrejti me ponë.	35	
Hiri mbrënda e vate thell nd' ato kamara te zeza, pjonoheta me muhi. Sfilaqisi zon e saj e m' u mbilaqis vet. Zuri prana te m' i thoj: "Se ti, zot e zoti jim, mos te jesh me mua mixor, po si u qeva me tij besullore e pjonohet mall.	40	
Mos me le te barjem nde ketë thelle filaqi, te me barjet kesheti, te me barjet zilona, te me mbjaket faqja. Po kujto si t' erdha nuse, si te ti, pjonohet harë, mema e prindi me derguan".	45	
	50	
	55	

[N]

Më qelloi, qelloi gjumi zotin tim, e do t' më fjër. Do t' më fjër, e u këndonj, më këndonj e dua t' e zgjonj, moj nd' e zgjonj çë kam t' i thom?	5	
Ti fjë njom, o zoti jim, e së gjejiën si gjëmön dheu prë nën armiqëshit t' armatosur e t' dirosur, çë dhifisnjin po sa ngasën, vjedhën, marrën e po vrasën,	10	

gjak e dëme shprishënjin".  
 Zoti gjegji e më u stros,  
 më u vesh e armatos  
 e nd' armiq më u shtëllua, 15  
 rë je shprishur erjes.  
 Më këndonj zotin e tim,  
 m' e këndonj e m' e gëzonj.  
 Zoti jīm, qarrun i lārt  
 për mbi çuk të malevet; 20  
 zoti jīm, një lis i gjër  
 hjë-i-madh ndë fushazit;  
 zoti jīm, ait e lez  
 çë më zbiret qiellëshit;  
 zoti jīm, mahjere e ngürt 25  
 çë më pret mahjerezat  
 xerkun e të Turqëvet!

[O]

Ditshkurturi Varroc,  
 trim i bukur e i bëgat,  
 rā mbë dīr të madhit zot,  
 cili duoj t' e xhishënej.  
 Rëndi atij paguomet: 5  
 ka një dit një llaudhitūr,  
 ka një jav një kumisār,  
 të paguonej shkreten kot.  
 Shiti ai murrën lop  
 me të gjith lopësār: 10  
 kotën s' mundi t' e paguoj.  
 Shiti murrëzën pela  
 me të gjith pelakān:  
 kotën s' mundi t' e paguoj.  
 Shiti mēndērēn dhēn 15  
 me të gjith delēmēr:  
 kotën s' mundi t' e paguoj.  
 Shiti dhjet pēnda qē  
 me të gjith punonjēr:  
 kotën s' mundi t' e paguoj. 20  
 Shiti arat verdhullore,  
 shiti dherat gjerullore:  
 kotën s' mundi t' e paguoj.  
 Veshi e mbathi bukurēn,  
 m' e limothi e m' e pastroi, 25  
 më e qelli ndë markat.  
 "Kush m' e do të bukurēn?".  
 Mosnjeri m' i vënej prec,  
 aq i dukej se vëlej.  
 Më rrëvoi nd' atë markat 30



Arminoi e shokëzit.  
 Bjejt ai të bukurën  
 katërdhjet mij aspet.  
 Më paguojti kotëzën,  
 moj, i nëmur e ji shkret 35  
 pa të bukurën ndë tal,  
 rā ndë thelle merëngi,  
 u sëmūr e duolli trushi  
 e, ndë rēnde llavēni,  
 vate vet e më u mbit 40  
 nd' ujet e të lumit Drīn.

[P]

Më këndoj, këndoj një zog  
 afër udhjes, kaha shkoj  
 Arminoi e shokëzit  
 me të bukurën tek ila,  
 të kaluome ndë një kal 5  
 bardhullōr si borazit  
 të Sklavunit e Qeravnit.  
 Më këndoj e po çë thoj?  
 "Popo, popo, çë shërbes!  
 Puthēn vllai të motërēn". 10  
 "Gjegjēn, o zot, çë thot kī zog?".  
 "Ēsht një zog çë fjturōn".  
 Adhrianopull më rrēvuon,  
 më e qelli ndë pēllas  
 e, je ulur ndë një thrōn, 15  
 zū t' e pienej hōll hōll:  
 "Kuj gjērī më jē ti, vash,  
 e ndë dhē të albēresh  
 ku m' u leve e teku vise  
 bashk me burrin çë të shiti?". 20  
 "Ndë podhē të Sklavunit,  
 ka perndōn dielli,  
 leva u sēmadhēshit.  
 Kishnja trī vëllezērith  
 çë më vān Turqēvet. 25  
 U qëndrova e varfērez.  
 Moj e rritur më besoi  
 me nj' bujār mīr i bēgat  
 nj' emēt çë më duoj me māll".  
 "Ç' emēr kishin tēt vëllezēr?". 30  
 "Ish i vogēli sī-ji-bardh,  
 këmb-i-shpejt e gjith i lez,  
 e ja thoshin Kallino.  
 Kish i diti sizit  
 si dēlia e dejtīt, 35

si thellia e qiellit  
 e ja thoshin Marino.  
 Ish i treti hjeshëm trīm,  
 sī-ji-zi e rishkëllqēm,  
 çë më luoj e më kërktoj 40  
 mose shpata e po mahjere,  
 e ja thoshin Armino ...".  
 "Motëra ime, cili fān  
 më të suoll tek it vëllā?  
 Arminōn çë ti kujtōn 45  
 ruoje afër e m' e çōn!  
 Mbjoji asaj podhën dhinār,  
 prëhërin, karçelezit,  
 e me kuel e shokëri  
 m' e dërgoi ndë Albëri!". 50  
 Të përlipe më gjeti shpīn,  
 vrërta kamarat e shkret  
 shtratin të martuomes.  
 Stisi ajo një monoshfir  
 e pë' mbrënda m' u mbëlli 55  
 e m' i qe varr e shtëpi.

[Q]

Ai Draghuti, ç' ish kusār  
 aq i fanëm sa i lig.  
 me një anī të madhe, gjere  
 e je thelle sa je larte  
 fluturoj prë dejtet 5 v. e.: më gjavlonej d[ejtet]  
 po si qifti maleshit.  
 Ai Draghuti dha me prōr  
 të së shpejtes sij anī  
 te proiti të Koronit.  
 Zū të shitij e të bjej, 10  
 si shesōr i qofç e i llargh,  
 petka ndrishe shortashi.  
 Moj nga zonjat e Koronit  
 mos e njera u kallār.  
 Moj e mira zonja Rīn 15  
 vetëm ajo më u kallār  
 ndë names kriatevet.

[R]

Iku trimi ka shtëpia  
 e lëreu të sijën grua,  
 kūr atij më ju fjandaks  
 se ajo m' e tradhizoj,





vijin mose po kushqī horashi, katundeshi afërishta je të llargha.	15	
Jëma e të vëllezërit nëng deshtin prë njerī, njera sa dërgoi t' e kish një bujār ka dheu lëti	20	
tej mbān dejtīn ndë të madhen Itallī. Deshtin e t' vëllezërit, më se gjith i vogëli, çë kish ëmrin Kostondīn.	25	
Jëma e vetëm thoj se jo, po i pandehjij zëmëra diu se çë të llargh e zī. Moj i thonej Kostondini:	30	
"Mëma ime, jipja motërën këtij bulari ka sëmadhīt Tarandjot". "Bīr, e kūr t' e dafëça o mbë lip o mbë harë, kush të vër po të m' e sjell?"	35	
"Vete u, mëm, e t' e marr!". "E m' e taksën mbë vërtet?". "Si vërteta ë kriqeza, ku tëhojqī Zoti Krisht!".	40	
Bën kushqīn e Gharandina vate mīr e me shëndet, nuse shūm je dashurez ndë një shpī tarandjote, ku gëzoi e lisaroi, bëri bīl e më i rriti	45	ms: u rriti
bularisht, e i mbësoi. Prë ndë hora t' Arbënīs friti rënd nat e dit, friti prë një zet dit nj' ër e ngroht e qejbëtare, çë më vinej ka shkretia të përtej Anatollīs e ka malet e Morēs.	50	
Rān sēmūr mose gjind, rān sēmūr e u ngeqëtīn e të ngequr diqëtīn. Ajo jëm e fanēmīr njër pas jetërin buor të nënd bilëzit e më rā ndë lip i thëll, shkret e je rrëmaksëme, keq meruome kolloghrë.	55	
Visij ndë të errten shpī	60	

e së duoj të shih njeri nga të pak qëndruorit.	65	
Erdh je shtunëza prë shpirt njerzëve të së besjes mbë Perendin shellbuos.		leggi: mbë Perëndin shellbuos.
Gjith e veshur mbë të zeza, zonja je meruome duoll e vate nd' at qish, ku më kish të bilëzit varrevet të pjuhurosur:	70	
ka një varr vū një qëri, një qëri e një llumbardh, moj mbi varr të Kostondinit di llumbardha e di qiri.	75	
Je përgjunjur, dha me krie ndruollshit e zū tu klaj, zū të klaj e të vajtoj, moj më Kostondinit thoj:	80	
"Kostondin, o biri jīm, ç' është besa çë më dhë se ndë lipe e ndë harë venje ti të mirrënje Gharandinen tët motër e ndë shpī m' e sillënje të m' levroj o të m' hajdhoj?	85	
Njota, besa jote rri bashk me tij e qetëmez ndë kt' varr, e bënur hī".	90	
Kūr çë qisha u mbullī, ku vajtuan e qajtin zonja ndrishe për të bil, shoqëra e motëra, çë ndë vit vëdiqëtin, tundi Krishti gropëzën ku më dergjej Kostondini.	95	
Varrit duoll si trim i ri, gropa më u bë një kal brimtullōr e pjono gjëll, qatëra m' u bë një sel me të zezën ndënbarkere, paravithen e të tjera petka çë më duhëshin;	100	
vokulla çë mbanej gurin m' u ndërrua nd' ërgjëndullōr frën çë mbanej kalëthin.	105	
U ngalua e drej u shpīt vrap e i anangasëmith vendit ku po mīr e dij se më visij Gharandina. Më rrëvoi ndë mjezëdit.	110	

Gjeti nipërat që luojin pas dalanishavet, cilat kishin bër folë ndën qaramidhavet të pëllasit faqegjër e m' i zëjin leqeshit. "Çë më bëni, nipëra?".	115
"Bredhëmi me këta zoge. Kush më jë ti, zoti lal?" "[Jam] ëkël Kostondini. Ku më vate ëma juoj?".	120
"Mëma vate lodrashit, lodrashit e vallevet prë harën të Pashqëvet". "Rrango, bër, të m' e thërrëç". "Ea, mëm, se arrū lala!" "Cili lal, o bërri jëm?".	125
"Arrū lal Kostondini". Shqiti zonja lodërin e pa frīm e llaftarime rrodhi vrap ndë sajën shpī, ku më gjeti të vëllān.	130
"Kostondīn, vëllau īm, cila ër të suolli". "Era e mjezëditjes. Mëma të lutōn ndë shpī. Erdha të t' mirrënja".	135
"Flitëm dreq, vëllau īm. Ndo se arrure ti mbë lip, vete vishem mbë të zeza; ndo se arrure mbë harë, vinj atje si gjëndjem".	140
"Nisu, motër, si të zū heral!". Më e vū vithë kalit e u nisëtin e më vān.	145
Tuke vatur udhjes gjatullore e je pa fin, Gharandina të vëllān vrej e ruonej me cjudhī. Çajti prana qetëmīn Gharandina e thoj atij:	150
"Kostondīn, vëllau īm, shëng e keqe më të shoh: kraht e tënd të gjeret jān të muhasërith; shpata jote, ç' ish qarute si një spër dielli,	155
ni rruxarme më t' e shoh". "Gharandīn, motër' ime, shkuan di vjet që ushtrashit	160

nëng më vajta, ku shkëllqeme mbahen ërmt e brezërat, e të veshurat m' i zū muh'ja e merimaga".	165	
"Kostondīn, vēllau īm, nj' etër shēng të keq' u shoh: lesh tē tū tē dërrudhjar ēsht tē pjuhurosurith".	170	
"Gharandīn, motëra ime, më tē bēnjin sizit ka buhoi i t' udhëvet".		
"Kostondīn, [vēllau īm], tē hjēmadhit tīm vēllezër, nipërat e mbesazit, si sē duken po tē dalēn t' emētes përparanith?".	175	ms: vēllezë
"Sē na presēn ndē ktē dit". Tē rrēvuor kundrela pllasit e pri s' afuri horjes, thoj pameta Gharandina: "Kostondīn, [vēllau īm,] njē sinjāl tē keq më shoh: gjith dritoret e pēllasit jān tē mbullituraz".	180	
"Thomse sod te hora jōn friti rēnde ajo vorē, çē ti dī po se na ngrīn prē ndē dimër eshtërat". Tuke thēn ashtu rrēvuon dhja ndē dēr tu qishjes. Muor e foli Kostondini: "Gharandīn, motra ime, u m' e mora prē zakōn, ndo tē vete, ndo tē vīnj, tē më falinj tēn Zot. Hinj ndē qish e truhemi. Ti me māl tē jēmjes ngit ndē shpī e puthēme". Tha e më u ndajtin pr' atē hēr e prē gjithmōn. Njize kali u bē varr, sela qatër e freni vokull. Kostondini rā i vēdekur.	185	ms: dritoren
Gharandina, e vetēmez, gjith e trēmbur e pa frīm, je rrēvuor te der' e shpīs, kūr m'e pā tē barjem, ngau me dridhēm trokullēn. "Hap derēn, mēma ime!". "Kush më jē ati te dera?".	190	
	195	ms: Kostini
	200	
	205	
	210	



"Gharandina, bila jote!".	
"Mba tutje, bushtra vëdeqe, çë më kuorte nënd bil, e me zân e simes bil erdhe ani të marrëç mua!".	215
"Hapëm derën, zonja mëm! Jām vërteta Gharandina, Gharandina, jotja bil".	220
"Kush të suolli, bila ime?".	
"Mua më suolli Kostondini!":	
"Kostondini? e ni ku ë?".	
"Hiri ngjish të truh'jet".	225
Zgardhamendi derën e jëma.	
"Popo, bil, vërteta jë Gharandina e dashurez. Moj vëllezërit e tū jān të pjuhurosarith	230
gjith sa ishin e ndë varr!".	
Të lloruor e të shtrënguor, tuke qajtur e vajtuar, po ka hejmi e ka dhëmbima diq e bila e bashk e jëma.	235

*Serposëma e të parës pjes*

[U]

Nd' ato male të Janinës m' u shtëllua një mot i keq: bumbullima e shkepëtima, gjëma e pika hjidhëshin nga ca rë të zezullore	5	
mbaru, e gjith anëshit draghonarja vij përpara rëndullore e kanosishte e tue shtūn breshër e shī koqeshi të rrëmbullore	10	
si lajthit e t' Okridhes. Dhjet xhatār, çë kīn përzūr dhejpërën të malevet, gjith një herje u shprishëtin të kërkojin një rëpār	15	
ku të mund kumbisëçin, kush një faj e kush një lis. Moj një pjak pa frim ndë gjī vate ndën një keperis e ka timi dridhej gjith.	20	ms: dridhj
Po sa lartit u poshtua një kopile kalimëne,		

kript-e-kuqe, sī-e-zez,  
 buz-e-qeshëme, pjote gjëll.  
 E lloroi e m' e shtrëngoī 25  
 e m' i ngrohu eshtërat.  
 Pjaku, prjerr mbë vetëhën,  
 thirri, sa gjëmoi mali:  
 "Lumi u, ji lumi pjak!  
 Kush e pati fanin tīm 30  
 ndë sa gjind gjënden te jeta?".

[V]

Diq Korina, cila rriti  
 zëmërmadhīn Milloshīn.  
 Diq e mjela keq e rë;  
 diq, e shūm je qajtīn.  
 Milloshini s' mūn të shuoj 5  
 hejëmin të thārt e thëll  
 çë mbullij te zëmëra,  
 e po qaj e keq shërtoj.  
 Tue shërtuor mbero penxoj,  
 e penxoj se çë të bëj 10  
 prë kujtīm të jëmavet.  
 Vate stisi mbi një māl  
 lartullore një kullōn,  
 mē je trashe se një lis 15  
 madhullōr e i vjeshëmīth.  
 Katër anëshit i fitepsi  
 dërrudhjār një qeperis,  
 villostare shejëqe.  
 Prana ndën asaj kullōn  
 eshtrat vuri t' ëmavet: 20  
 të se jëmës bjerrafate,  
 cila e leu e nëng e rriti;  
 të së murges emëte,  
 cila e rriti e nëng e leu.  
 Shkruojti pra nd' atë kullōn 25  
 pri s' kundrela të vorës:  
 "Nga vorea ndo ti rrëvōn,  
 burr o grua, kushdo jē,  
 ti përpara mos më shko,  
 moj kētu dica qëndro 30  
 e dhjavas të shkruomezën.  
 Ndën kësaj kullōn më fjēn  
 di kopile, çë ng' i gjēn,  
 ndo se gjith ti ecën dhēn,  
 se si ato së jān o qēn; 35  
 e sa bëtin ng' e rrëfien  
 mose i biri vet ç' e ndien, ms: mose se

cili t' ëmat qajti e qān  
 prë sa il te qielli jān".  
 Shkruojti pra nd' atë kullōn 40  
 pri s' kundrela perëndīs:  
 "Ndo ka perëndia rrëvōn,  
 burr o grua, kushdo jē,  
 ti përpara mos më shko,  
 ti përpara mos më shko,  
 moj këtu dica mëno 45  
 e dhjavas të shkruomezën.  
 Xëj se ndën kësaj kullōn  
 grua je shëjte rri për mōn,  
 cila ngjallëti një të dekur  
 e po botën bëri hekur. 50  
 Ajo rriti një ghanjūn,  
 cili s' kish spërënx gjakūn,  
 se pse t' ëmës prej të dis  
 i qëndroi zënur ndë sis":  
 Shkruojti pra nd' atë kullōn 55  
 pri s' kundrela mjezëdits:  
 "Ndo ka mjezëdita vjën,  
 burr o grua, kushdo jē,  
 ti përpara mos më shko,  
 ti përpara mos më shko,  
 moj këtu dica mëno 60  
 e dhjavas të shkruomezën.  
 Xëj se ndën kësaj kullōn  
 rrīn ca eshtra prë gjithmōn,  
 cilëvet bekuome i nget  
 e parrajsi me shëndet. 65  
 Njera e leu, jetra si bīr  
 t' unglin rriti e deshi mīr,  
 dhja si t' sajën vetëhē,  
 e u rrit e i bëri hjē":  
 Shkruojti pra nd' atë kullōn 70  
 pri s' kundrela haraksīs:  
 "Ndo ka haraksia ti vjën,  
 burr o grua, kushdo jē,  
 ti përpara mos më shko,  
 ti përpara mos më shko,  
 moj këtu dica mëno 75  
 e dhjavas të shkruomezën.  
 T' ëmën e t' emëten mbëlloi  
 ndën kësai kush e lartoi.  
 Ka të rrīn një stoneōn  
 amënōr me tēn Zōn. 80  
 Ndo ti shkōn me lipsī,  
 ato eshtra kān hajdhī  
 e të bënjin atje lārt  
 Krishtin t' ëmbël, jo të thārt,  
 e ndë qiell të butësonjin 85  
 Krishtin e me hīr të mbjonjin".

## NOTE

Il titolo *Rapsodie* manca nel ms. Tra parentesi quadre sono indicate le integrazioni dell'editore, come, ad esempio, le lettere maiuscole che identificano alcuni testi non numerate dal Santori. Si auspica che vengano sollecitamente pubblicate le sue *Rapsodie* custodite nella Biblioteca Reale di Copenaghen, più numerose rispetto alle presenti, conservate nella Biblioteca Civica di Cosenza insieme ai manoscritti delle altre opere di questa edizione elettronica, eccezion fatta per *La Divinità di Gesù Cristo*.

Tra le composizioni, alcune solo accennate, sono inframmezzati appunti attinenti all'ordinamento definitivo, dai quali emerge chiaramente un Santori mirabile creatore e non semplice raccoglitore di rapsodie (11: 69 "Una canzone da farsi").

53, 6 "Ilauditür", auditore giudiziario.

[T] La leggenda di Costantino e Garentina nel rimaneggiamento del Santori occupa 235 versi di fronte ai 132 della versione raccolta dal De Rada (*Rapsodie d'un poema albanese*, Firenze 1866, p. 29). Il giudizio del Gangale (*langatmige Verwässerung* / prolissa diluizione) coglie, in questo caso particolare, nel segno.

*v.e.* = variante espunta dall'autore.

# S A T I R A T

## 1. E vobëka e ligë

Thoj ajo: "Ndose gjëllinj,  
kam spërënxë se dita e mirë  
sod o nesër ka të më vinjë,  
e, më parë të des, një hirë  
kam të e shoh edhe këtu,  
të venë të tjerët posi u!

5

Lipinj bukë e thonë se s' kanë;  
një liverëz nëng më japin;  
trokollonj, e se nëng janë  
bën e xë, të mos të më hapin.  
Pjasinj timit e njeri  
nëng bufton për mua lipsi.

10

Pishkalaqëra kam t' i shoh  
ndë këto udha e prë ndë dier,  
tuke lipur me një vohë  
hejmëtare ndonjë lërier,  
një tul bukë e një'etër gjë  
çë të i lipset më e më.

15

Po të njohin si i thartë  
është të lipurit, e si  
kush të veshurën ka t' artë  
s' ndigon çë ndien ai  
çë për timt stafidhjoset  
e nga uri pjasën e loset.

20

Hanë e pinë, ngrohen e nguqen  
posi mareza je pjekur,  
fjën si lirat e ndërluqen,  
ndën pojaca rrinë të qepur,  
mirë stolisen e buftonjin  
posa kanë e më mallkonjin

25  
30

fatim çë ng' i dha më shumë  
petka, rgjënd, ar e turre  
me bunënxje, si një lumë  
çë është i pjotë; po të ftesë  
bënjinë më të rënda e më  
mos t' i japin vobkut gjë.

35

Vafçin gjith si vete u  
prë ndë dier e më përzënë  
gjithë. Mos pafshin fare ku  
kriet e kurmin mund të vënë,  
pjaftshin urit e njeri  
mos i pafshit lipisi. 40

Ndë te qielli je ti, Zot,  
keq i drejtë se Theos,  
e gjëllin për mot e mot,  
tas e njeh se bretkosë  
u s' jam; moj jam e tërë  
si të tjerët me ligjë e bërë. 45

Gjegjëm andaj e gjithë ata  
çë s' kanë për mua gjagjë  
maj s' pafshin e ndër ta  
shtrëmbërisht u ruofshin më  
lig se qentë, kur çë hanë  
ndë një koritë e shumë s' kanë". 50

## 2. Kopilja mashkullore

Anëterezja, cila bëj  
bukureshën e kushqit  
mbaj për poçe e zgjidh e lëj  
një për një, muori hit  
për një ari! U mbjak e rrij  
me të sajën virgjëri. 5

Duk se thoj se kalloghrenë  
duoj të bënej ndë shtëpi.  
Ëndërrij shoqëra e me pen  
qaj të zbjerrën bukuri.  
Moj e zeshka, prë sa bën,  
më një shoqëth nëng e gjën. 10

## 3. Gjithon'ja gjuhëgjatë

Nikollina me sa kish  
burra e gra ndë gjithoni  
semre zëhej e se ngë ish  
thoj si ajo mbi dhe njeri:  
moj pëstana kur spovisi  
edhe pula më e cimbisi. 5

Patëtin ghust se me shëndet  
vate gjuha gjatullore

cila mosnjeriu ndë jetë  
lënej nder o hje ambënore,  
moj i shaj e i përshaj  
e nga mizat bëj një maj. 10

Thoj: "Të shtrëmbur ka kjo  
hundën e gojën, e mbënjane  
dhja si gërthja vete ajo.  
Gjithë të shëmtuor më janë  
njerzit te kjo gjitoni  
e ngë sheh të drejtë njeri. 15

Si u lenë? Ç' vjen me thënë  
ki shërbes? Ngë vren me çerë  
një të bukur; si të bënë  
qenë me topër; e si skalljer  
duken të ashpër më se janë  
e poka kondra e vixe kanë. 20

Kush me ghualjar e me vocë,  
kush me koshin e më i brutë  
është se ursi e si një stoc  
druri duket. Si kukut  
faqen kanë të verdhë të tjerë  
e të shtipur e të gjerë. 25  
30

Mjera u! Ndë mes të këtire  
kam gjëllinj, posi një lule  
prë ndë gjëmbe, e nikoqire  
jam ndë bajta e si kukule  
prë ndë ferra. Çë më vlen  
bukuria çë më shkëlqen?". 35

Tuke thënë ashtu me gjithë,  
gjithë i lodhi e m' i varesi.  
Si ndë çerë edhe ndë vith  
thojn posi vej shërbesi,  
e, si ajo së lëj njeri,  
gjithë e zëjin pa lipsi. 40

Nuk u mbjak se diq e re,  
e të madhe një ndonatë  
brutullore la mbi dhe,  
sepse pati gjuhën e gjatë.  
Ni ku zëhen gra me gra  
Nikollina pjesën e ka. 45

#### 4. Këpucëtari e qepëtari

Xhan Frangjisku bëj këpuc  
e i qepij ngushtullore  
aq sa tekun nxëj një vucë  
hij një bute madhullore.  
E ngolisur si mund rrij  
sholla? E ditën e jetër bij. 5

Sod të taksij se t' i bëj:  
pas di javë ashtu të thoj;  
i mëritur maj të lëj,  
qellij dhunë ashtu e dërgoj  
një shërbeme ka një ditë  
të ish e bënur ndë një'tër vit. 10

Anangasej më se bleta  
prë ndë lule Zepareli  
kur çë qepij e vërteta  
ishin bathë, jo koqe meli,  
pundët çë të bëj e pra  
shqepëshin më se petku ata. 15

Mund e ruonje me sa si  
ka paghoj te gjeri bisht,  
se një arnarjel të ri  
dij t' e shehij ndë një gjisht  
e kur pritij frëng frëng  
ndë një xhaket vidhij një mëngë. 20

Taksij se të vij ndë dit  
nesër, e pra së gjëndeje më  
ndë katund kuazi një vit.  
E mbi gjithë ndë i jipnje gjë  
prë paguome, ahierna andaj  
shehej mos t' e gjënje maj. 25  
30

#### 5. Punonjeri

Zepareli kish prë mjet  
një liksht pend qe:  
ndë të mbjella shkonej vet  
mbë vilaqe ai mbi dhe  
se di pendë ngë bëjin, moj  
nd' ato ara drapëroj. 5

S' kish të trëmbej se dërsij  
o se pankë prë ndë këmbë  
më e lart mund i vij.



Hjorovola ndë pullëmb  
mëngu dukej, e i zoti  
thoj se kish ftesur moti. 10

Paparun! Ftesi ai  
çë ngë i bëri argomën thellë  
e për një i qelli di 15  
xhavlave ghrëll ghrëll,  
dheun i shprishi me parmend  
e si çot e la kutjend.

## 6. Gruaja pitare

Haj si derk e pij si ka  
ndë një katund një kalloghre,  
të bëgatë cilën e la  
zonjë i shoqi e grua të re,  
ndo mbero së martohej 5  
e me një'tër nëng shokohej.

Ajo mbeti pa u martuor,  
e çë bëri mos të shkoj  
gjellën e gjatë pa u helmuor?  
Dimbëdhjet bute mbjoj 10  
musht të zgjedhur, se nga muoj  
një për vetëhenë e duoj.

Bëj dhivoten e ndë qishë  
gjegjij meshën nga menat,  
ndë të veshurat ngë kish 15  
gjë të bardhë. Moj karitat  
së kish prë ndonjeri, e mirë  
derën e shpisë mbanej të mbëllirë.

Buk e djath e hjiromerë  
haj, e pij, e fjëj dhjet orë 20  
natën, e ditën di o tri herë  
vej ndë shtrat; e një kurorë  
patërnostrash mbaj ndë duor,  
po me gjithë se rrij qëlluor.

Ndë katoq vate një ditë 25  
se të shih veronjëzat  
mos të rridhëjin, e ju shqit  
dreq nga zëmra malli i gjatë  
se të njihij posi dij 30  
te kallmoreza ndo pij.

Zgjodhi buten më të mirë  
e ndë kallmore u picikar.  
Moj, dëthir tuke dëthir,  
keq u deh e u stunar  
aq sa së diti të mbullij, 35  
se pse shtuora së mund të rrij.

Ra për truolli e vera i vej  
gjithë ndë faqe, e murga thoj  
butes më të mos lirëj,  
se sa piu sosi e shkoi 40  
shëngën edhe, moj shurdhullore  
butja shtij pa thënur jore.

Pra nga vera kuazi e mbitur,  
u qëndrua pa bënur gjë.  
Vej me dorë verën tue shtitur, 45  
si të thoj: "Jo më! jo më!"  
Butja u derdh e, kur rrangoi  
poshtë e mbesa, lucën çoi.

Sheh çë bënjën gratë që pinë,  
se më zi se burrat janë! 50  
Plasin, djegin, e shtëpinë  
e gremisjën, e ndo kanë  
petka shumë i bënjën pak  
mbjatu, o fare, si ajo pjak.

## 7. Trimi i llavur

Ndë se dijit se çë bëri  
Fulliberti, qeshjit gjithë:  
me gërshërë tirqit i tëri  
e u vu ngaluor ndë vith  
të një ghadhuri, cili e shtu 5  
dreq tek vendi tek u vu.

Kriengulaz vate ra  
e me nder atë buftoi  
çë nganjë mbuluor e ka,  
e si një majall qëndroi. 10  
Fishkëllejin gjith, e rrij  
barkalartas si një kunij.

Pas një copë u ngre e vate  
tue graxuor si kacamite,  
pak i dhëmbi ajo shkopate 15  
gazeshi çë pati, e prite

se të nguqet. Sikur maj  
kishim thënë atij; andaj

hiri ndë një katoq e piu  
verë sa mundi e derdhi trut. 20  
Zu të lozij prana i ziu,  
moj s' i njih gurët e drut.  
Kushdo deshi ahierna e mundi  
e kushelt mirë ja shkundi.

Duoll atena e tue mallkuor, 25  
se ndigoi se buori shumë,  
si i llavur udhën muor  
se të vej të fjëj ndë lumë.  
Te kështënjat kur arru  
rrukullisi si një dru. 30

Vej aposhtaz si një thes  
pjot, e bënej: pufti pu!  
Gjëmbat nëng i patëtin bes  
e je shquortin mbaru ashtu  
si lëvere çë qe vjerrë 35  
ndë një murriz, për t' ish e shqerrë.

Ati e ëma je kërkuon  
prë një dit e prë një nat.  
Tek e treta prana e çuon  
gjithë të shqerrur e shangatë, 40  
gjims i dekur, ndë një përrua,  
pa një gjisht e pa një thua.

## 8. Kallonjeri

Ai Dhuminku vate hiri  
ndë një shtëpi të vidhij mbrola.  
Kur u pruur, i sfanëmiri  
tijën e gjeti e bërë si Llola:  
ndose i pari jep ndë mest, 5  
i merr gjith sa janë turrest.

Qau se i bëtin një karicë  
keq të rëndë, se i paruon  
eshtrat me një shat me pizë  
e kështu pra e dërguon, 10  
tuke thënë se kush vjedh  
pjesët e mira nëng i zgjedh.

Bjerrafati pat të dhuroj  
sa i pësoi, e të rrij qet!

Moj të nxirij brin penxoi 15  
pas ca muoj e pas ca vjet:  
nëng i arruri dreq shurbesi,  
se dhisinji u shquor te mesi.

Vate i çoti me ca të tjerë 20  
ç' ishin më se ai vjedhtar  
të kallojë, e ata bujerë  
deshtin pjesën më të parë.  
Vuri ai diu çë mbënjane,  
mori ata për nxërr e vranë.

## 9. Zarritasi

Ai demokrati çë kish 5  
gjuhën e gjatë sa një shpat  
e je zëjë me këdo t' ish,  
flitij semre, dit e nat  
murmurisëj, shaj, turpëroj  
kudo rrij e kudo shkoj.

Ish i njohur ndë katund 10  
më se një ndë nëmërat  
nga sa di rrëvoi ndë fund:  
ish i vet e bëj për shtat.  
Trëmbëçin njerëzit më atij  
se ndë deqa ngrah i vij.

U mboshtua një dit ndë aghor 15  
e u vu të batallisij  
e të bëj shënga me llor,  
se më dhezej e sërritij.  
Së ndëgojin se ç' thoj,  
po më gjind prë nën i arrvoj.

Kur u mbjodhtin aq sa pak 20  
kin qëndruor prë ndë katund,  
veçse ghroçit e ndonjë pjak,  
me fuqi të madhe u tund,  
ruojti rreth e zu të thoj  
sa kanjë mund e ndigoj:

[zgurdhulloi grikën e sit,]

"Lumt ju! Nani s' kini 25  
lipse më nga ndonjeri.  
Mund lodroni, hani e pini,  
posi burr ç' i dejtur rri,  
çë ndë menat njera ndë mbrëma,  
si djal ngjeshur nga e jëma. 30

Zoti rregj e kamarat  
më se mir ju ndreqëtin:  
jo me një, me pes e shtat  
lidhëza ju lidhëtin,  
aq sa më njeri së ka 35  
ënd të ngrëhet ka ku ra.

Një duani vetëm nani  
kin të mbani ju ndë tru:  
të paguoni, mos ai  
të ju vërë me bith ndë hu, 40  
posi Turqit u zakuon  
se të bëjin kuji së paguon.

Dheun ju lan të ja shërbeni,  
pemat prana i mbiellën ata.  
Se të shitëni e të bjeni 45  
lefterin lexhja ju dha.  
Vet një pjes ju merr notari,  
kuartat një'tër, e rregjistrari

merr di dhjetme. Trëmbësinë  
më së kini të ju bënjin 50  
tek asizat ndonjë tërbim,  
njer që artikullin ngë gjënjin  
avukatrat ndë lexh,  
cila ndreqet si një sexh.

Ndose lehi, nje ju shkruonjin 55  
ndë ca livra, se të dinë,  
kur martohi, të kërkonjin  
pjesën e tire. E prë mullinë  
çë ju bënjin? Duon paguor  
ka një koqez çë është e bjuor. 60

Ndose kini ndonjë shërbes  
se të bëni me njeri  
çë rri llarghu, pa nderes  
mund i shkruoni e anangasi.  
Katër sollde sa lëshoni, 65  
vete karta tek të doni!

Është vërtet se cado herë  
udhën e bier e nëng rrëvon  
ku për lusni ju të verë,  
se ndonjë je hapën e ruon. 70  
Moj këtu stesën njeri?  
Kanë të bënjin lefteri.

Tue shërbier ndo ghadhnjeni  
ndonjë gjagjë, si të bugetë  
pjesën e kurtjes ki' t' lireni,  
e je vetma pjes ju nget. 75  
Ndo ka të ju jap njeri,  
duon të e xënë me hapta si.

Ndose kin të jipni ju  
s' duon të dinë e ng' i mborton 80  
fare fare. Presën ashtu  
të vëdisni e prana thonë,  
si gjëri të mirë çë qenë,  
po se pjesa atire i vjen

nga sa lëni e nje ju duon 85  
je mbë petka; moj kërkonjin  
vetëm ërgjënd e kuj s' paguon  
ndë ca mot ja shumësonjin  
di o tri herë e, mos ngë gjënjin,  
ndien sekuestrin e pra lexhën. 90

Ajo shet, pa të kërkonj  
judhikon e judhikime!  
Moj çë bënj se ju kujtonj  
ca shërbise çë lingime  
bën e ndieni keq të thella, 95  
sa për nxërr ju thahet gjella?

Ndo mos jetër, kripën vetë  
kish t' e jipëjin më të lirë,  
se, kur një gjëndej i shkretë  
e pa fare gjë të mirë 100  
më mbi dhe, si një sardeje  
mund kriposej ndë tineje

e të mënojë ndonj'etër ditë  
pa u grisur. Të kërkonjin  
të vdekur, pas një vit, 105  
vën te varri: ahierna çonjin  
një paguome keq të re  
çë vërtet ngë u pa mbi dhe!

Ni së kanë ku marrën më:  
qishat e kumunet gjith 110  
tas i xheshëtin, ndo kin gjë,  
çë ndë xerk njera ndë vith.  
Këdo kish mir e qëruon  
e stomaqin nëng e mbjuon

e të uripst e djegur urit 115  
më buftohen e turp s' kanë  
të i lipnjinë molla gurit!

Dogitin gjith po kudo nganë  
e Italljen si shigjetë 120  
bën të mbrazëtë e të shkretë!".

U përgjegj një pjak e i tha:  
"Ti kurraj së fole dreq,  
moj tue thënë nani këta  
the vërtetën keq e keq!  
Moj ndë i gjegj nga ata njeri, 125  
nje të vëj ndë filaqi.

#### 10. Spiuneshat

Popo popo! Xhuzepina  
hëngri lakra e nëng u xu;  
e vindarti Paskallina,  
njize bëndin vate shtu  
e bumbllloi prë ndë katund 5  
çë ndë krie njera ndë fund.

Zun të flitjin e të thojin:  
"Kush e di çë lakra qenë?".  
Cado tjerët më e zgjerojin  
tuke ruor shtrëmbër shërben, 10  
njera pra çë diu ç' thanë  
e mbi derë murgën e nganë!

Karrubina, çë vandohej  
se sa bëhej nga shtëpi  
vet asaj nëng i mbulohej, 15  
tha se hëngri ca nguli  
e ca rrapa, disa pite  
me ca sarde sapurite.

Bëtëtin rroqe e nje Tereza  
u përgjegj: "Si njoh, këtu 20  
jini gjith me tru të leza!  
Dreq shërbesin e di u  
posi vate e posi erdhi  
e llanxhelen kush ja derdhi!

Vej e zeshka se të gjëj 25  
ndonjë rrësheje e parpalidhe  
e njeriu po dëm së bëj.  
Moj ca njerëz çë me cimbidhe

venë tue gjënë qimen ndë ve  
së manguon kurraj mbi dhe!". 30

"E çë i bëtëtin?" Margarita  
piejti. E Rezja: "Kush e di?  
Thanë se Kaku Mallavita  
ngrah ju hjodh me mall të zi.  
Burr i lig! Çë duoj nga ajo?". 35  
Njo nani çë pien kjo:

"Mua më thuj çë duoj e deshi!"  
"Ec e piej për vetëhenë!".  
Margarita ahierna qeshi  
e i thoj: "Kush të ndëlen?  
The se dinje e së di gjë,  
rremtare sa jo më!". 40

Gjith sa je lëshuon një gaz  
e Terezja u humb e u nguq,  
moj, nga turpja kur u mbraz, 45  
duoj të hap nj'etër sënduq  
e të thoj diu ca shërbise  
të pësuora nd' ato vise,

sa një pjakë u bë përpara  
e po thoj: "Çë janë këto  
fjalë të liga me të shara  
çë m' i jipëni? Ndose ajo  
juve thoj, sa thoni ju,  
ju pëlqej nani kështu? 50

Mbëllini grikën! Çë të e bëni  
ndose hëngtin o gjë jetër  
bëtëtin njerëzit; sa më xëni,  
më pa nder buftohi, e nj'etër  
juve thotë ndë krah edhe  
se ju bëtë këtu e këtë". 55 60

"Fjat me ligj", përgjegji Roza,  
pjak je mirë, çë arrvoj ah'jena  
e ngarkuor me ca skorca.  
Gjith u ndurpëtin e atena  
vanë nganjë te saja shpi,  
ca me paq, ca me nodhi. 65

## 11. Pijëtari

Aq ka vera çë dëthiti  
Xhikarjeli u bë si derk:



katër herë truollin lëpiti e u ngji njera ndë xerk. Pra, për një të bënej di, vate piu te kroi ati.	5
Kur me uj verën përziejti, nje stomaqi iu tërbua: sa se i tundej murgu ndiejti, zu të villij si një krua. E sa gjind shkojin atej gjith e ruojin se po vej	10
tuke ratur e së dij çë të bëj e çë të thoj. Ndë një suport u ngul të rrij tuke mbarë dorën ndë gojë. Mbë serpos atje mënoi aq sa gjumi më e qëlloi.	15
Kur u zgjua, kushejt i ngau, moj ca sollde nëng i gjeti. Zu të nëmij si Kallau, e çë bëri ahierna i shkreti? U shtëllua prë ndë katund se t' i lipij njerzvet kund.	20
Gjithë e qeshëtin e përqeshëtin, dhja si derku meritoj. "Çotëra qenë çë nëng të xheshëtin!" nga njeri çë e piqij thoj. Moj përligu, si u adet, diq i dejtur e i shkret.	25 30
Ati e jëma e kishin lënur mir të ndrequr e të bëgatë, moj ai kështu tue bënur shumë te gjella nëng u ngjat. Trim spovisi e posa kish gjith për ver të shitur ish.	35

## 12. Nxërrëtari

Pandaleshi mbi gjërshi gjeti Ëngjëllën çë haj. Zu të pritij me diri: ajo murga thirr e qaj. Mbë serpos u shtu e shtëlloi. E gjërshia? E prerë qëndroi.	5
---	---

E galufi Pandalesh  
ruonej dëmin e po rrij  
i qanduor atje si presh.  
Parë të motërën që vij, 10  
prap një tupi vate u sheh,  
si njeriu që turpën njeh.

Kur gjërshin gjeti të prerë,  
zuri e motra të dërgoj  
nëmë si breshër: "Këtë verë 15  
mos e shkoftit!" - dirëme thoj -  
"E je preçin posi preu  
këtë gjërshi e je lireu!

Kish tri tumën pema e ni  
nëng vlen për mosnjeri!  
Sod e parë që bënj ati 20  
kur të vinj e kur të rri?  
Ku kam luginj griken më,  
kur së kam ndonj'etër gjë?

Njota pemët sikur qanjin  
gjithë të veshkur e njëmend 25  
qe je prerë. A, për Shën Janjin,  
se të qendronja u kutjend  
doj të e kesha gjetur kur  
rrij të e prit ai ghadhur! 30

Kushdo qe, qoftit i vlarë  
e je qellçin copa-copa  
ndë një duok, si ca vuçar  
bënjin kur gramisën lopa,  
o si mishtë kau i pjak 35  
qent e hëngërçin ndë një lak!".

Pandaleshit ran ndë tru  
ato nëmë të zjarrullore  
e, rrëmbier atje një hu,  
duoll me çerë të farmakore. 40  
Ngrah ju hjodh e njom të njom  
aq e bëri sa ngë e thom.

Xurë të bëmjen djejëmit,  
nje i ngrëjtin një stori  
të ja këndojin nat e dit 45  
e po thojn: "Pa gjërshi  
ni si bën më Pandaleshi,  
tas që e preu e pemshi e xheshi?

E të motrën ngarkoi  
me shkopate ashtu të rënda 50  
sa që ahierna nëng façoi  
më nga dera, e thomse mbrënda  
është e pjasur. Ndo të desë,  
Pantaleshi ka një pjesë

keq të mirë ndë filaqi, 55  
posi burrë që motrën vrau  
prë një pjake zezë gjërshi  
e prë nëmët mek e ngau".  
Kënkëza qëndroi e xënë  
e të e thonë kurraj së lënë. 60

### 13. Vjedhëtarja e shtëpisë

Fillomena, cila fjëj  
bashkë me t' ëmtën, i vodhi  
miet e vate se të gjëj  
një gjitone, cila i mbjodhi  
mbë tumact. Barkun mbjuon 5  
e një ditë haremez shkuon.

Mori e jëmta, kur e xu,  
me një frushërë kurmin i shkoi  
e nga shpija përjashta e shtu.  
Fare e liga nëng mbësoi: 10  
pati semre duort e gjata  
e të gjera si lopata.

Gjithë e njih'jin se si rrjet  
mblidhij pishq të vegjil e medh  
e mbaj dheun si një det 15  
ku kanjë ka ligjë të zgjedh  
pjesën e tij. Andaj rrëmbej  
më se mundij, kudo vej.

Mbero maj pati të mirë  
gjë ndë shpi, e je zbramarme, 20  
sembre liksht e je sfanmirë,  
si ndë të keq e dhistinarme,  
tuke vjedhur e kalluor  
pak u vesh e shumë u shquor.

Sa më e njih'jin se po shkoj 25  
vet ajo ka ndonjë vend,  
gjithnjëri njinje kërkoj  
të mbllihej ndë një mend.

Ruoj ndë kish gjagjë përjashta,  
se ajo mirrij edhe kashta. 30

Sa fëmija kish katundi  
gjith i ngau e i shënoi,  
pak o shum. Mbero ngë i tundi  
keq mbë nxërr o i hejmoi  
aq të e qelljën ndë kurtë:  
prë këtë u qell e urtë. 35

Vetë e ngrohtën cado herë  
me të rrahura të tharta.  
Qenë për ta si shiu ndë verë  
çë u duthitën. Ndë vende larta  
nëng rrëvoj të mirrij gjë,  
se njeriu çë ka së fjë. 40

Diq e mjera ndë një katoq,  
ngrën nga morrat e nga të tjera  
lipse rënda, e nëng u poq,  
moj u dogj si frungullera  
gjithnjëherje, e si gjëlliti  
lig, ashtu gjellën mbulliti. 45

#### 14. Nëmëtarja

Marjanela kish një dosë,  
çë së e lëj ndë rugh të vej  
prë ndë katund. Një her u stros  
mbi një djalë, të më i rrembej  
copën buk çë kish ndë duor  
e të di murgut ja shquor. 5

Dosën e vran, e ndë shtëpi  
më të murgës nëng ju pruur:  
zu të qanej me hjidhi;  
tuke nëmur e mallkuor,  
duoll te dera e prë tri dit  
gjak thërriti e mënit: 10

"O çë pafshin aq pojata  
posa qime dosa kish,  
e ndë zemër aq thikata  
prë sa rrotull dosa ish.  
Bëjme hirën, Zoti Krisht,  
bëj të i shoh me çerë prëmist. 15

Si pa shoke bëtëtin mua,  
qofshin gjith pa shoke ata. 20

U gremistit ndë një përrua  
kush si kalloghre më la.  
Kriet i preçin e, ndë ka bil,  
gjith ja shtiptët një dërstil".

15. Dhivotja e rreme

Katarina, cila thoj  
patërnostrin me dhjet  
fjalë të shtrëmbëta, buftoi  
të ish dhivote ndë këtë jetë  
me ca bëna paghanishte 5  
keq më shumë se krështërishte.

Nisi e vate e keq njëhere  
suolli spartën ndë shtëpi  
po të bëj një frungullere  
si ngë e bënej mosnjeri. 10  
Mbë vurtet e çeli e vej  
rreth asaj këtej e atej,

tuke thënur cado fjalë  
çë i ndigonej vetëm ajo  
e shtrëngohej si një ngjalë 15  
jasht nga ujit, e maj ato  
desh të mbësoj njeriu e bëj  
gjithnjeri të mund i xëj.

Tuke vat këtej e atena  
afër zjarrit e tue bënë 20  
ca shëngime hapej shena  
e me gjin mblidhej prë nënë.  
Ish je pjote gjitonia  
e ajo thoj "Gëzot Maria!"

e thërritij me një zanje 25  
si kumborë rgjëndullore.  
Ndoçë e gjegjënje, mëngu hanje  
prë ajo ninë triëmbëlore.  
Pjashin gazeshi tue ruor  
njerëzit, e ajo me duor 30

mblidhij urth e vëj më sparta,  
po të bëj zjarrin më të madh,  
vambë sa të vejnin aq të larta  
po sa dit dukej nd' aradh.  
Djejmët zun të e kaptojin 35  
e thërritjin e këndojin.

Ajo kish ghust e hare,  
sikur bënej një shurbes  
keq të mirë e pjotë me hje,  
more thomse kish për besë 40  
se për të, kur të vdisij,  
Zoti Krisht mboshtej të e nisij.

Bjerrafatës një shkëndil  
tek zilona ju ngallos  
e një vërë i bëri ndë il. 45  
Kur u adunar u stros  
ndë ca balta se të shuhej  
e u ngjia mbjatu si duhej.

Strosi e jëma me një shkop  
se të i njomij brinjëzit; 50  
tue thërritur si një lop,  
bin e qeshjin njerëzit.  
Thirr e jëma e bila atje,  
bën të mirë një mirr e le.

#### 16. Zbesullori mallkonjëtar

Paskalluqi, çë kish vrarë  
një derkth sa një ghadhur,  
hëngri mirë ndë Kalivar  
e ndë Kreshëmet. Pra kur  
erdhëtin Pashqët agjëroj, 5  
ruonej njerëzit e shërtoj.

Ki vandohej tuke thënë  
se nëng njihej Zotin Krisht  
e te qisha maj kish qënë.  
Moj, një ditë çë i hanej mishtë, 10  
pas të asaj graxoi si kal,  
shkau e çajti atje një shal.

O, sa Paskalluqëra janë  
çë ndë qishë jo vet ngë venë  
e ndë prënte pinë e hanë 15  
mish e sa përpara i vjen,  
moj së dinë të thon një fjalë  
pa një mallkuome sa një malë.

E përshanjin Perëndinë  
e turpëronjin shënjtërat, 20  
skandalepsnjin njerëzin  
se me gjith të shtrëmburat

gojën e kanë të pjetë të pjetë  
kundër dheut e tënit Zot.

E shërbenjin të buftonjin 25  
se ng' i kanë për fare besë,  
moj pëstaj kur i mallkonjin  
mir zbelonjin jetrën pjes.  
Thonë se jan një faregjë  
e i mallkonjin më e më. 30

Kush u llav po të mallkoj  
një shurbes çë nëng e dij,  
e prë fare e ndikuroj  
ndose ish, tundej o rrij?  
Janë të thëna gjith këto 35  
cilat grisen prë ndën to.

Sa më thonë se besë nëng kanë  
më buftonjin se kan besë  
e të përtrëmbur ashtu jan  
prë të bënurat fëtesë,  
cilat i thërresin fort 40  
e i tramaksënjen si mort.

E ata bënjen si djali  
cili vete tue kënduor  
ndë errësir te dushku o mali 45  
e më thirrën tuke pushtëruor  
thirrmët e tjera çë fjandaksën  
mendja e mbrënda je tramaksën.

Sa mir ish ndë gjithë këta  
çë mallkonjin të qëndrojin 50  
(jo pa krah e këmbë, se pra  
gjith limozënen kërkujin)  
vet pa gjuh e të vuvosur,  
se ngë mallkojin të thimosur.

#### 17. Mjekërari

Nd' ultare si një nuse  
të ulën e ndreqën Zepareli,  
shtron mbësallën e ti kërruse  
sa një koqes trokomeli,  
pra me gjishtërat të nget 5  
e të nditet se të vret.

Shashën merr, faqen të shkon  
me ca bardhullore shkom,  
cila më se adur dërgon

një djallosurë vërromë,  
hundën të rrëmben me dorë  
çë në gushtë e ka si borë. 10

Me një hekur pra të rrjep  
dhja si derk ndë magje i vrarë.  
Sitë shtrëngohen, lot't si qepë  
faqes poshtë ven tuke rarë. 15  
Ai bën se nëng ndigon,  
qimet pret, faqet punon.

Sa mbaron të thotë: "Prodhoft!"  
pjot me gaz e me hare. 20  
Thua mbë tij: "E prerë të qoftë  
dora çë ijzit bën e pe!".  
Pra i përgjegje edhe pa hir  
se të verë shëndoshmë e mirë.

#### 18. Rremëtari

Rrafan'jeli vreshtën e tij  
ruoj e tek e tjerët haj;  
ndo të flitij, thoj se s' dij  
petkat e njerin, e laj  
duort, e bënej si Pillati,  
moj të mir udhën ngë e mati! 5

Gjith ata çë qenë të ngarë  
u ndiguon e bën kuvend  
e një dit çë ng' u vindar  
gjithë mbë qetës e pa stjend  
van e i voltin vreshtëzën  
e, si bëri, atij qe bënë. 10

Kur te vreshta i murgu vate  
e m' e gjeti tas të vjelë,  
zuri faqen me shplakate  
ture thënur: "Ndë të mbjelë  
ka të ruhet mirë njeriu,  
se çë mbuolli ata i biu!" 15

Para e prasma ndë vërteta  
qe kjo çë i duoll nga gola. 20  
Semre bënej si shigjeta  
e si zorrat prë ndë kola:  
më të rreme mbillarosij,  
se pa nxërta nëng shkallosij.



Së dij të thoj mëngu një fjalë 25  
pa të thonej një të rreme:  
ka gjërpëra bëj një mal  
e të shitura e të bjeme  
po vandoj e vëj ndë thes  
ndonjë galuf çë i kish besë. 30

Pra çë e njohtin, mosnjeri  
e mirr vesh o i vënej re,  
tas çë dijin se ndë tri  
fjalë tri rreme vëj ndë hje,  
e nga gola e tij vërteta 35  
dël si arëza nga bleta.

#### 19. Shërbenjëtar

Nakaruqi kish një pjënx  
çë e ngushtoj e bëj të gjerë,  
si mirr bukën ndë vëllënxë  
o shërbej prë të o prë tjerë.  
Kish di shatra, një të lezë, 5  
një të rëndë, e kaq një brez.

Kur shërbej për të shtrëngo  
pjënxin fort me brez të gjerë  
e me shat të rëndë rrëmoj;  
bukë e qepë ndë dimër e verë 10  
haj, ne semre mund i kish,  
e kurraj prëvonej mish.

Vej pa brez e pa u shtrënguor  
kur shërbej prë të tjerë  
e me shatarjel ndë duor; 15  
të ish ndë dimër o të ish ndë verë,  
katër herë lipij të haj  
hloromer, bukë e mëraj.

Murmurisij e rëkoj  
mos ng' i shkojin verën edhe, 20  
keq ashtu shokët mbësoj  
se të bëjin. Me këdo qe,  
semre u zu, se i paguor  
ish përpara, e u kish harruor.

Pra çë haj e pij më mirë, 25  
mbë hare vëhej si zot  
e shërbej ashtu me hir  
sa të bëj ndë motëmot

më se njetër bëj një ditë:  
çë ndë menate mbrëmën prit. 30

Nd' ata ende si një hu  
ndreqej shtuora e zëj të flitij,  
i kumbisur ndë mërur  
të së shatit, e thërritij  
e rrëfiej dica storia 35  
po të i gjegjij shokëria.

Semre i shitur si kusi  
të penguome nga satori,  
qellij dhunë miq e gjëri.  
Moj ndë mot çë kuorej gruri 40  
bëj shërbise çë së mund thuhën,  
se nga nxërëra njerëzit kruhen.

Katër bila qell me të  
e të shoqen çë ish arpi,  
cila ng' është kutjend me një 45  
gojë të pjotë e semre rri  
je zbramarme e më dëthin  
sa jo drunje një kaminë.

Ture kuortur dorën hapij  
e kallinjët më të rënda 50  
lëj të bijin. Shoqja e mbrapij  
e i mblidhij keq me ënda.  
E të bilat nëng e lëjin  
hJOROVOLIN tek e gjëjin.

Më se vrukulit, nga shkojin, 55  
mblidhjin gjith e kallamen  
aq të bukur e qërojin  
sa pra punonjeri dhenë  
gjëj të vetëm; mëngu kashta  
mblidhjin prana horat prëjashta. 60

Ndë katund ku ish i lerë  
njihëjin mirë kta shërbise  
e ngë i pa të ditën herë.  
Moj nd' ata të huojë vise  
Nakaruqi ndihej keq 65  
e ng' shërbej, si duhej, dreq.

Vet një ditë mbero për vend  
bëj, se jetërën nëng e duojin,  
sepse gjith i lëj skutjend  
e ndë si, njohur, e ruojin. 70

Njera pra që diq ndë hi,  
se ng' e deshi më njeri.

20. Mjeshtri drujtar

Natën e ditën tuptisij  
mjeshhtë Anemi ndë një katoq  
errëtullor, ku mund vëdisij  
edhe trimi më i doq.  
Moj ai atje tue mbetur 5  
pak e pak u kish adetur.

Pritij, ndaj e shkatërroj,  
pra ngolisij e përziej  
sa dërrasa mund të çoj,  
ndose krimbi e miu gërriëj. 10  
Tetë o dhjetë shërbeme nisij,  
pra ndë tjera motin grisij.

Bëj sënduqe, triesa e dera  
e dritare e vëngarjele,  
katarrata me grurera 15  
e stamare e gamjele  
e vandohej se të bëj  
akuillën që ndë ajër fjëj.

Moj dritarja pas di muoj  
bin e shihnje të ilëzuor 20  
qiellin, e je hapur së duoj,  
se je hapte kish qëndruor  
nga gjith vendet prë vetëhenë  
e të nxirnej atë penë.

Te sënduqet ndë mërkat 25  
vejin brumbulit e mit  
tuke bënur rrumuratë;  
maçja s' kish ku të vëj sitë,  
se nga vendet gjith të ndajtur  
lëjin të ikjin pa i mbajtur. 30

Thanë se ndë të tjera bëna  
një mbaroi që gjith i shkon,  
posi natën pjote hëna  
ilet vrën e i mbulon:  
zoti Ndre deshi të bërë 35  
tries e gjerë për katër llërë.

Kish një bir e të e martoj  
afër ish, e duoj andaj

tries e gjerë, ku të mbitojë gjind së madhe, çë kurraj qënur ish ndë atë pullas ka gjërit ndo horëtas.	40
Mastranemi i tha: "Më nget të të shërbej si meriton, ndë mjeshtëri u i vetë mund të bënj sa ti kërkon: ndë tri ditë t' e siell të bërë, të limothër e të tërë".	45
Shkuon tri muoj e zoti Ndre nëng e pati triesën. Mbë një shkazun nj'etër tre gjëj Anemi pa e lënë të mëritur. Të paguhej diti mirë më se ngë duhej.	50
Mbë serpos i nditij keq turp e triesën ja e bëri të ngolisur gjithë prë dreq, se me gozhda nëng ja tëri. Gjithë harem ja qelli, e Ndreu se të haj ja parashteu.	55 60
Haj Anemi e tuke pirë verë di vjeçe mbëllij një si, vet mbë të tue thënë: "I mirë keq shërbesi e gaz i ri ka të më jetë kur hanë këtu dasmëtarët, e thom u!".	65
Kruojti kriet, u ngre e vate se të bëj ndonj'etër mbrolë. Pas një javë, një llogë e gjate rrij ndë tries me hapte golë se të haj e triesa ish e ngarkuor vidhënxje: kish	70
gjith të mirat mbal. E shtitur thomse nga njera anë, u nis pa të mund e kishin ditur: gjith u zgjidh e u gremis mbi vetëhen e u përziejtin sejat posa in e u liejtin	75
dasmëtarët, e më shpëlqeu se të nuses te podhea një tajur me lëng kërceu e i bëri sa folea	80

të një korbi kondër e gjerë  
e i gremisi cohën e bjerë

katërzet dukat. Një lip 85  
qe ndë shpi për dëmin pasur:  
gjithnjëri me hund si pip,  
mir shërbesin tuke masur,  
nisi e vate se të haj  
ndë shtëpi buk e mëraj. 90

Zoti Ndre bëri "Popo!"  
prë shërbesin çë pësoi.  
Mastranemi i thoj: "Çë do?  
Kush ftesi? Kush ngarkoi  
triesën me vidhënxe shumë 95  
e me verë çë bëj një lumë".

## 21. Hekurtari

Bumblisoj për nat e dit,  
prë ndë gjith gjitoni,  
çë nga një te jetri vit  
ndër të tjera e vet një shpi:  
ish ajo ku shtipij hekur 5  
mastër Rrafi, çerë i pjekur.

Dhjetë dhishipuj kish me të  
e sa jip një kopane  
nj'etër dhjetë bijin nd' atë:  
gjith fishkëllejin me hare 10  
e të bëjin një armoni  
çë kush gjegjij vetëm e di!

Ai Vullkani, çë ndigoi  
se shurbesi nëng pëlqej  
njerëzvet, vate zgavoi 15  
një putigh ku të shurbej  
nd' ato llarghu e thella male  
e ndë gjera e shkreta zale.

Prë dhishipuj me xhudhix  
zgjodhi burra me një si 20  
e të shurdhër, se këtë fix  
s' mund e bënej mosnjeri  
çë të tërë kurmin e kish,  
ç' i tërë në skiset ish.

Mastër Rrafit (cili maj 25  
xuri ndo Vullkani qe

nxjerr nga qielli prësandaj  
se rrëmur bënej atje)  
pak i dhëmbij se gjëmoj  
e katundin gjith shurdhohj. 30

Se të thomi pra si vete  
dreq shërbesi, nder i nget  
se të bënej me duor të shpete  
çë do lipset te kjo jetë  
hekurisht. Duonje një thik,  
një pijuor o një llimik, 35

gjithë të i bëj. Po kish një vix  
se nga hekuri tri pjesë  
me të hollin artifex  
bën e shkoqshin, turren  
duoj pa kund, të pinej verë  
me një gilic si lumi i gjerë. 40

Sod i thonje se një shat  
tij të lipsej. Nje të thoj  
se të e bëj njera menat,  
pra një muoj allmeno shkoj.  
Mbero sembre ai shërbej;  
e të shërbierit ku i vej? 45

Nëng e dij çë i thoj njeri,  
ish si ursi çë dëthinë  
uje sipras e ndë gremit  
thomse prana bëj llavin.  
Semre i xheshur, liverisur  
vej e i shqerrur e i grisur. 50

Ndë ja thoj njeri hejmohej,  
me këdo të ish ngreshtej e zëhej;  
hjidhej e pëstaj fitohej  
e si vajtë i njomith bëhej:  
mblidh turp e kopane  
e gjëllij ashtu mbi dhe. 55  
60

## 22. Puthighari

Me tri llira zu të bjej  
Kokotati e të shitij ver.  
Semre gjimsit ghadhënjej  
e i hejmuor dukej ndë çerë.  
Thoj se së kish gjë katandi  
e je bëj për mikëri 5

të dicave që lutojin  
se të kin një qelq i mirë  
e sa duoj nëng e paguojin  
e ja sillij për pjaxhir, 10  
moj një mik jetrin thërriti  
e më shumë i prasmi piti.

Prë të parëzën me vucë  
shiti shehuraz, pëstaj  
mbrazi bute e, ndo një puc 15  
kish, ng' i sosij. Si mëraj  
hajin semre ata pitarë,  
më i paguojin ar e bar.

Zu ndë krah të çotravet  
të zgjeroj buthikëzën. 20  
Dica vejini me shëndet,  
ai, semre tuke i ngrënë,  
bjenej ver të mirë, të zezë,  
e me uj e bëj të lezë.

Gjith me uj i pakëzoi 25  
ndë ishin turkëra të lerë,  
e mos jetër i vobëktoi  
mos ngë i bënej të kërshterë,  
moj ata si milingona  
më rrëjidhëjin ndë raciona. 30

Kur i pa se kin të gjata  
veshët, muori më fuqi,  
duort i hapi si lopata  
e kopre e bajt e hi  
mblidh e atij sa vej ndë duor 35  
nje mbë rgjënd gjëndeje ndërruor.

Zu të mahej e golotën  
duoj më të ëmbël e të pjot,  
e je shoqja, që dhivotën  
bëj, të qajin me më lot 40  
thartullore gjinden shtij  
e nga qisha vej e vij.

Di masore mbaj i shpejti,  
një të drejtë e rremtare  
të jetërë, e shiti e bjejt 45  
semre ashtu. Kur fare fare  
thoj ai se ghadhnjej,  
për di her shitij sa bjejt.

Kur çë bjej gjagjë njeri  
e s' ghuallarëshin ndë prec,  
mirrij be mbi bil e si  
e të rremen thoj për vec.  
Gjith e njohtin se kalloj,  
mosnjeri të flit ghuxoj.

50

Kur të majmit ju ngallos  
ndë gëlic, i mjeri vet  
u fukar, posi një dos  
çë haj eshtëra, cila u gjet  
e spovisur e je fritur,  
me gërlacin të mbullitur.

55

60

Patën ghust ahierna gjith  
e, të shtrëmbur posi jan,  
zun të i fjitjin prapa vith  
njerëzit e një mijë i than.  
"Tuke vjedhur keq u ma"  
thojin "murgu e nani ra!".

65

### 23. Mushkëtarët

Kur i mir e lipisjar,  
pjono hir e karitat,  
Krishti vate mbi Kallvar  
se të bënej një dhjatë,  
ture dekur, me njerinë,  
po të i jipij lefterinë,

5

ndrishe njerëz më e shokuon  
ka rromant e ka judhetë,  
moj ndë kriqe kur e shtruon  
inë atje sa janë ndë jetë  
gjithë nacionashi po gjind,  
mbë mijar, jo se mbë qind.

10

Thanë mbero se atje ngë qenë  
mushkëtar e qerrëtar  
bashkë me tëjerë, të jipjinë penë  
kur mbi kriqe e patëtin vrar.  
Moj si vate çë këta  
pjesë ngë patëtin me ata?

15

Populi, çë cado herë  
është i urt e është profet,  
na përhapin një mister  
ligjërisht e me vërtet.

20



Andaj vete tuke thënur  
se këta njerëz mbi dhe të lënur

qenë të vënë jetën mbë kriqe 25  
ka njëmend, e ndë shtridhore  
të i shtrëngojin si rrëshiqe  
ku qe vajë, e ashtu hejmore  
të gjëllinjë sa rron burria  
prë ndë lipe e ndë hjidhia. 30

Kush e shkruojti këtë stori  
e përvoi për vetëhenë,  
se tue vatur prë fani  
ktu këtë, tuke ecur dhenë,  
ndodhi semre mushkëtar,  
ghajdhuras e qerrëtar. 35

Sa gjëlliti, maj u zu  
ai njeri me këdo qe,  
mushkëtarët e bënë pa tru  
e u ngroh këtu këtë 40  
o për të shtrëjtin prec çë deshtin  
o se e vodhtin e je xheshëtin.

Mosnjë herë pa një shënim  
shkoi, sa herë vate me ta.  
Njihen gjith e kan ndigim 45  
posi dirqit; e dica  
njeri me jetrin nëng padhiten  
ndo të zëhen o të vriten.

Kur të ngrënit i kalluon  
e mbi gjith ndo pati verë 50  
ja dëthitin e i mbjuon  
pra me ujë rrogjenë. Më herë  
eci murgu e agjëroi  
e qerrasi pjënxin mbjoi.

Me gjith duoq një herë i muortin 55  
ca djath e verë e mish  
bërë ndë furr. Ndë një'tër i shquorëtin  
një panarez teku kish  
me ca verë një gjel i pjotë  
e je lanë esull si çotë. 60

Ndo të i flitij, një fillar  
parandrequr me të rreme  
kin ndë gol ata vjedhëtar  
e me faqen po të treme

thojn se vjedhëtar ai ish, çë duoj nani!	65
Nj'etër herë një qerrëtar i kish dhënë kaparr një copë; prana vate një bujar çë do të ecij mbë ghallop e qerrasi më e lëshoi e nga copa as ndikuroi.	70
Dimbëdhjetë sollde një herë taksi njëj se të i qellë një sunduqith gjatë e i gjerë sa një pëllëmb e pak i thellë ndë një vend i afërt e ai më i rrëmben njëzetedi.	75
E ndë gjithë duoj të rrëfiej sa pësoi me këto gjind kush çë shkruon, sa karte ngjiej! Duhicën qind e mijë mbë qind! Moj mbero sosën sa tha të xënë gjithë kush janë këta.	80

#### 24. Vjedhëtarja pulashi

Anëmaria shërbej të rritij pula e gjela e një mixore ka gjithë motin pritij se të bënëshin madhullore. Ja kalloj e me ca tjera bëj tumac e haj, e mjera!	5
Anëmaria sa her çë gjëj se i mangoj një pulë o një gjel, dil te shkalla e thirr e bëj si një madhith këmborjel e dërgoj të zezën nëmë çë njeriu ngë i bënij dëm.	10
Moj ca bëna keq të rënda Perëndia nëng i do. Ra sëmur mixorja e mbrënda zuri krimba e mëngu ato van t' e gjëjin mek u mbashk e tue ngrënë u mbjuon si mashk.	15
Diq e kajbët e njeri, kur spovisi, nëng i pati një thërrimez lipisi.	20

Kur e ngrëjtin qejbej shtrati  
si një gropë, e prifti edhe  
llarghu asaj mbahej tutje.

Di çë e qellëjin kin të mbëllirë 25  
hundat me një skamandil;  
mosnjeri më e qaj, o mir  
thoj asaj, o motër o bilë,  
moj sa e shihëjin nje kujtonëçin:  
"Hëngri pula, e liga!" thonëçin. 30

E mallkuome ashtu nga gjithë  
shkoi e vate ajo ka dheu,  
cila dogji e shpoi si hith  
e një ndonat të lig lëreu!  
Gjithashtu kan desën ato 35  
çë han pula posi ajo.

#### 25. Vashëza çotëz e gjiton'ja e shpejtë

Gjith e bukur, baxhanele,  
ish je bila e Julljes.  
Vej te kroi me tri ranxhele  
e me duor mbahej ndë mes.  
Tundej, shkundej, sikur të ish 5  
pjot me pjeshta e një ngë kish.

Qeshij e buftoj ca dhëmbë  
dhja si breshër bardhulllore  
e të vogëlaz ato këmbë,  
dillikatez atë dorë. 10  
Posa trima kish katundi  
gjith ajo mbë mall i tundi!

Pas i vejnin posi vete  
rreth linarit pallarea.  
Ajo shpejtë si shigjete 15  
ngrëhej ndë ajër, lehtë si rea.  
E me shoket po vandohej  
se ngë duoj, në mos martohej.

Ndë aq të nisura kushqi  
së dij të mirrij o të lëj: 20  
lip andaj nga ato vuli  
si shurbesin kish të e bëj.  
Dhunë e qellëtin e ajo  
së ndigoi çë thanë ato.

Një gjitone ndër të tjera e vindarti se ndë tru pak o fare kish e mjera kripë e të porsinej zu të i kallojë të jëmës gjë se ja mbaj e rritij më.	25     30
Paparelja i pati besë: pruor e vate ndë shtëpi, muori atje një konjënë fes e je mbjoi me lesh e li. Nisi prana leth e qet të ja qell gjitones vet.	35
Thoj asaj: "Njinje, njinje bë t' më tierën se kam bënj di o tri linja; njota se, di ç' kam, u bënë si rrënjë, mëma fare së më kujton: pjaftça e ajo ngë e ndikuron".	40
E gjiton'ja thoj asaj: "Bila ime, ti nani tas u rrite e ndëse vaj ndë linar të vësh ngë di, gjënde prana ndë errësirë, pishkalaqe e pa të mirë.	45
Bëj nani çë mundën e ke lefterin të bësh gjagjë, se, kur e martuome je, më të rritur tek e lë ti e gjën e trashigon, moj ndo së vjove mëngu çon!".	50
Ditën e jetër qet e lezë qelli asaj e urta vash grur' e mel e prë një kezë çë të i bënej ca mundash; vaj, lathure, fiq edhe, të ja shitij më tutje.	55    60
Moj gjiton'ja me xhudix mirrij, mblidhij e i rritij prë vetëhenë. Ki artifix drej vërteta atire i gjitij çë vënë ujë ndë shosh e mbanjin se me të finjën kan lanjin.	65

Pas një jav që u kish martuor, dreq si gjëndeje nuse e re, duoll e vate tue kërkuaor prë gjithonen e cila nge së kish t' e gjejj, e sa shihij se ajo vej, shehej o ikij.	70
Mbë serpos një ditë ju poq ndë një rugh je ngushtullore; zu të i fjitij, me zë të doq, llastimisej je dirore: "Poka ti, si shoh, më zi je se tjerët ndë amahji!	75
Do të më i japç o thomse jo gjith shërbiset që të dhe të më i mbanje?". E verdhë ajo dhja si hitë mbë çerë, pa tre ju përgjegj: "O bila ime, s' di që thua!". "Për gjellën time,	80
si ng' e di? E kërp e lit që të solla ku më i vure? Mos e hëngërtin thomse mit? Grurët e melt e ato lathure që të dhe? Di tumën fiq ku i gremise? Ndë furriq?".	85
"Motra ime, ndë vurteta këto fjalë më thonje ti, dreq këtu, si jam e u gjeta, bën e viellëshnja nani! Mike qem e mike jemi, moj nderes së pat'tim o kemi".	90
"E thua ti me faqe guri se nderes ngë pamë! E kur djalli tij ndë zëmër vuri të më porsinje keq me kurë të kallonja gjë ndë shpi se m' e vjonje me amahji?	95
Ngë ishnje ti ahiena, pjake tradhizore, rremtare, dhejpër e ligë, që stise laqe trufarishi, e s' pate fare nderë ndë faqe? Ngë ishnje ti? M' e rremton këtu nani?".	100
Ngë ishnje ti ahiena, pjake tradhizore, rremtare, dhejpër e ligë, që stise laqe trufarishi, e s' pate fare nderë ndë faqe? Ngë ishnje ti? M' e rremton këtu nani?".	105

"Popo popo! Më shpëlqen se kushqia të bëri dëm! U t' e thom nani me pen se të ka zënë ndonjë nëmë! Dolle trushi, u llave, o bijë! Qelle lipin ndë atë fëmilë".	110
Shtij nga çera farmëkë e zjarr Mathallena e rrij t' i hjidhej se t' i bëj të mirë një barrë me të rrahura, moj mblidhej më e më gjind tek ajo udhë e je murga ra në kudhë.	115 120
Ndër të tjerit që rranguon ish i shoqi, i ati e jëma. Kur shërbesin mirë ndëguon, me mallkime, fjalë e nëma bënë atje si një markat murmurishi i gjerë e i gjatë.	125
Kush thërritij nga një vend, kush nga jetri kanosi bëj të rënda, e kush kutjend qeshij e po thoj: "Një bri merr nani! Të qethi mir lesht e të qëroi me hir!"	130
Mathallena ra zali e qëndroi sikur e dekur. Marr, e qellëtin ndë shpi, moj gjiton'ja, si një hekur ngurtullore, thoj: "Ndo kini martëri, të zotrat jini	135
të më thoni gjithë këto, se në mos ju bënj ngales se më kallun'jarti ajo e martuame me ftes!". Qetëtin gjith e ajo kaluor mir u gjënd e petkun muor.	140

26. Kopilja

Natallina qe je mir  
prë sa mbeti ndë shtëpi  
bashkë me të ëmën, cila nxir  
prë ndë gjithë gjitoni

ca novele, e thoj se po ngë ish mbi dhe n'jetër si ajo.	5
Ish e bukur si një lule, shpejte ish si dallanishe, më vëlej se një cakule çë është e pjot me xhoja ndrishe, e kudo të vënej duor bëj shërbise prë me u ruor.	10
Pastërtore e nikoqire, shpin të mbaj si një lartar; ish ashtu je fanëmire, se nga bota të bëj ar. U martua e gjith ata bardhë karizma bëtëtin çal	15
Dhja si pasëri kur bëj gjith këndimet e zogjëvet, cili kur deshi të bëj rrushinjollin murgu u gjet i çotëjasur e qëndruor vetëmith e i harruor.	20
Vetë dij të haj e të pij e të fjëj për nat e dit, ngroht edhe ndë zjarr të rrij çë nga një tek jetri vit. S' dij të qepij e të tirij e, ndë arnoj, më shpejt shqirij.	25 30
Bijt i ngjeshij si një dru ngjeshnjnin vashazit ca herë se të bredhin, e si një hu dreq i mbaj ndë prëhër i gjerë; prë të laj finjën dërgoi semre e maj vate te kroi.	35
Shpejt i shoqi sill me qerre, nxir ajo me prëhërua, nisi shpia prë ndë zbjerre e fëmija u vobëktua. Diq e bijçi një lloje la pa fare gjë mbi dhe.	40
Hapni sit, o burra e trima çë me gra duoni të lidhi, se jo semre shkepëtima qellën shiun, e, kudo mblidhi,	45

gjëni vend të mirë pushoni  
e për ngjaja gjarpëra çoni.

27. Kënkëtoresha e nusevet

Ndë gjith nuset Kërecja vej  
semre e para të këndoju.  
Mbero strofat i lirej  
dreq si kriet asaj i thoj:  
dij ca kënkë copa copa 5  
e muitij si bën lopa.

Pas asaj vejin të tjera  
tuke thënur një e një'tër  
kënkë, e pritij të arrëj hera  
të diftonej gjë të vjetër 10  
nd' ato udha tue shkuor  
nusezën të pabesuar.

Pas besuomet një'tër ënda  
pra ndë zëmërat i hij  
e kërkujn të ishin mbrënda 15  
nd' ato vende, ku të i vij  
mbarë të rrëmbejin gjë,  
kandonjë sa mundij më.

Kanë të gjera ndën karçelet  
e të thella, e duon të i mbjonjin 20  
me të dhëna, e më i çelet  
malli se të marrin e vjonjin.  
Posa shohin se ndonjë  
merr më shumë, e thon atë

pa zakon të ghavënar, 25  
e pra bënë stesu ato  
posa bënë tjerat më parë.  
Thonë dhe se kujdo  
së qe dhënë si mir i ngitij  
të shërbehej e je pritij. 30

Dalën e venë tuke u vanduor  
kush më shumë dhurim rrëmbeu  
e karçelen ka të mbjuor  
më të ndëndët e kuj dheu  
vate rrotull se u de 35  
aq çë piu e i duket hje.

Thanë se Krecja i porsitij  
se të bëjin aq turpri



pa u nguqur, prana i rritij  
posi deshi, gjithnjëri 40  
dhja si kish zakon, e vate  
keq adeti mbë të gjate.

Shkoi ka prindët ndë të bij  
i pahjeshmë i bruti adet 45  
sa nani ndë një fëmijë  
bën më spizë një nuse vet  
se ngë bënjin dhjet çë han  
fort, e verë më pin se kanë.

## 28. Ungjëlit e nipërat

Mirbëmi qe një burr  
çë shërbeu me trimëri:  
nga një kalidhe si një furrë  
diti e stisi një shtëpi.  
Eci dhenë, u rrit e më 5  
ghadhneju semre gjagjë.

Marr zakon e marr adet  
të shërbej, mëngu një dit  
mun të shkoj ashtu të shkret  
si nganjë te jetri vit: 10  
dhjvasij, shkruoj e bëj  
një shërbes kur një'tër lëj.

Nga të vëllezrit rroi më shum  
vet ai ndë gjell dica,  
sepse vixet si një lum 15  
shtun ndë varr sa qenë ata,  
e të bijët çë qëndruon  
ka të prindët ng' u llarghuon.

Pijin, hajin e të gjata  
kishin thonjtë e gjuhën edhe, 20  
pak rrëmojën ndë të thata  
dhera e mblidhëjin pak atje:  
nga i ungjëli prtëndojin  
male e dete e nëng e dojin

fare mir, megjithëse i veshi 25  
më e më herë e i gjëlliti  
ndë një vit i rëndë, ku xheshi  
uri njerzit e i shtiti  
ndë të thellë vobëkti  
e i la pa petka e shpi. 30

Nd' atë vit mos kishin pasur  
të ungjëlin të lipisjar,  
mbë këtë herë u kin mulhasur  
e të bërë nevojtar:  
Mirëbëmi hapi duor 35  
e ndë gjellë u pan qëndruor.

Më i jipij e më kërkujn,  
pa u buftuor të ngopur maj,  
prë sa mundëjin i kallojin  
e je qellëjin dhun, andaj 40  
rrisullviti të kërkuj  
një çë e duoj e ng' e kalloj.

Ki shërbes një shkundullim  
prë të nipërat e të tjerë  
qe, e bëtëtin një gjëmim 45  
gjatullore keq të gjerë,  
moj tue vatur moti pra  
bën e ruojtin drej dica.

Panë se Mirëbëmi kish  
mbë vërtet një vix, moj pra 50  
nga jetër anë i veshur ish  
me virtuta e prë nd' ata  
rishkëlqejin mirëria,  
fjaja e ëmbëj e lipësia.

Së dij të thoj një fjalë të rreme, 55  
së dij të bëj një dëm njeriu,  
ndë të shitur e të bjeme  
së gënjeu, more i ziu:  
dha për grurë tridhjet karri  
se të mbjidh njëzetedi. 60

Moj të nipërat nëng pushuon  
të thërritëjin e të thojn  
kundër atij e së ndiguon  
se më keq e ashpërojin  
tuke bënë ashtu; edhe 65  
than se do t' e vrisëjin. She

çë janë nipërat e gjëritë!  
Ndëçë jep e bën të han  
si te djathi bënëjn mit  
e të gjëllinjin me sa kanë 70  
vixe e ti shtrëngohe e grikën  
mëngu lanë me uj, se të ikën,

prë trëmbim se ata të së mahen  
tuke ngrënë e tuke pirë,

e të pastrohen e të përлахen se të duken më të mirë ndë krah tëndë, o trim o pjak çë të jesh, përқen ndopak.	75
Moj ndo ti прë vetëhenë mirë penxon e, pa pushim, tue dërsir semre shërben të mun kesh një trashigim kur të lipset, lig të thon, sepse nipërat nëng penxon.	80
Ata nipëra çë të shajtin kur i dhe e të kalluon e të dhënurit ng' e mbajtin prë righall, pse penxuon se i ngitij e nga ti duon sa bijvet së bën njeri,	85
e ng' e bënjin stesu ata, se ka ditë прë një gjërpërë zëhen e përshahen. Mba çë të bëjin ndo ndë llërë kin të qellëjin ndonjë mbëshuome prej të tjerëvet trashiguome!	90
Vëreni ani si janë pa tru këta njerëz çë претëndonjin të kumbisen si ndë hu mbi të tjerë e, kur arrvonjin se të kenë ngarkuome urdhin, hun e pjasnjin ndë kamin.	95
Duon e shanjin e kanosënjin, ndë gjith vende murmurisënjin, duon e dhja si borë të losënjin, duon e ndë së i jep të grisënjin. Pra ndo mbjake bën e des i pështruor mëngu me thes.	100
Ni kush qe ai njeri cili dha për vjet e vjet qindinar, e farmëki mbjodhi për rrihall, e qet mbeti, e prana, i murgu, kur hapi sit, u gjënd likurë	105
keq e thajtur e je grisur? E nani kush bes e ka e je ndien pa u cjudhisur këtë bëme? nëng u pa	110
	115

se grulishte prë ndë dhe?  
Mori ani shihet ndër ne! 120

Mirëbëmi dha e mbjodhi  
prë të dhënurat mallkuome,  
moj të likt nëng e lodhi  
e i përgjegji me të bekuome,  
kanosit ngë i ndikuron 125  
e ka bes mbë t'Ënë Zon.

29. Jatroi jatriser

Mbaj ca bare, kripë e gur  
ndë ca qejqe e ca fjalle  
zoti Maz, me madhe kur,  
e shëroj sëmunda e malle,  
thoj ai, me ato jatri 5  
çë kurraj shëruon njeri.

Semre vej prë ndë katund,  
dil ka një e hij ndë nj'etër  
shpi, si burrë të madhi kund,  
ndë urtëri i thellë e i vjetër. 10  
Shkruoj kartucaz prë rrixeta  
më se lule shkon bëleta.

Për kininë mbanej ca miell,  
të përzier me diu se çë,  
e sa ethe ishin ndën diell 15  
i shëroj e nxir me atë,  
moj përpara më i qëlloj  
me ca shtog e bar alloi.

Me jodhurin pra të bëj  
kurat më të gjata e rënda 20  
e kudo qindavra nxëj  
i shërbej përjashta e mbrënda,  
prë lakosat e lavomat  
kish di lote ka të njomat.

Me xhufit një simpati 25  
të djallosurë më kish,  
prë dhëmbimet barku i rrij  
t' i shëroj, rëmjedhi ng' ish  
tet o dhjet xhufitata  
e qëronej mir zorrata. 30

O furtuna o Perëndia  
çë më i ndihu, mir i vate,

kudo vuri duor, jatria.  
Ashtu ngrëjti një ndonate  
aq të gjerë sa dica 35  
than se ngjallij me ata.

Katandin mbero kurraj  
ngë e harroj e ndë nderes  
mirrij qindën e mijën, andaj  
u bugat e kish tures 40  
ndë gjith motet. Tërë t' arnuor  
kish të veshurën e shtruor

me të lier, dërsinj e val  
aq sa të jipij mirudhir,  
kur çë rrij njeriu ndë tal. 45  
Fjëj mbero si fjë një lir,  
prë dhjetë or nga dita, e rroi  
aq sa njerëzit i harroi.

Së desh të martohej e spovisi  
pa të bëj mëngu dhjatë. 50  
Nje gjërit si miza lisi  
u rrjodhtin e prë shtat  
bëjin, kuj të i ngitij më  
nga të lënurat gjagjë.

Po sa monu e vun ndë varr 55  
mir të xheshur si një gur  
lumi, dhja si qen ndë xharrë  
me undir o ndë një lëkurë  
me ca mish, u zun e bënë  
një jushtri çë së ka të thënë. 60

Zun të hajin e të pijin  
mbi ato petka të ghadhnjera  
pa shërbier e të dëthijin  
xhuta grofçi e shumë të tjera  
ghuste, njera çë qëndruon 65  
pishkalaq e u turpëruon.

Disjin urit e njeri  
nëng i ndëj të hajin gjë,  
i ngudhirjin pa lipsi  
e i shajin keq e më 70  
aq sa diqtin të dhisprarmë,  
ngrënur morrashi e dhanarmë.

Njerëzit thojn: "Pa shurbier  
së mund të hahet me sapur  
buka, e gruoja çë së tier 75

mëngu veshet. Sa pa kur  
neve arrën, ashtu na vete  
e qëndronjëmi si të shkrete".

30. Vobëktari i mir

Nga një katund ndë një'etër vate  
të gjëllij një burr i mir.  
Pati gjellën shumë të gjate  
e shërbeu sembre me hir.  
Me këdo vej e lëj kutjend 5  
e je lipëjin kudovend.

Posa rroj kurraj u pa  
i mëritur me njeri,  
ng' u përzie me burra o gra  
o me tjetra kondra u nxi 10  
çë turpëronjin, e me hje  
seembre qeshij pjot hare.

Ndë sëmunda nëng rëkoj,  
llastimisej e nxirrepsej  
kundër qiellit, o mallkoj. 15  
I pëlqej e shum harepsej  
me gjitonët, kur ndë mirë  
trashigojin të dulirë.

Pak o fare pinej verë,  
haj sa duhej të gjëllij. 20  
Gjë njeriu së ngau një herë,  
kurtën andaj nëng e dij  
ndose ish, e pak fjalë  
thoj e të ëmbla si mjalë.

Jip vëli të dreqa shumë 25  
kuj ja lipij e vërtenë  
seembre thoj, mëngu ndë gjumë  
ëndërrij të bëj dëm o penë  
ndonjeriu; ndo së shërbej,  
çë ndë menat te qisha vej. 30

E mënoj njera çë djelli  
mirrij udhë nga perëndima.  
Kjo gjellë ashtu e qelli  
prë ndë vapa e prë ndë brima,  
ndë të rëndën pjakëri 35  
.....si.

Bërë i verbër, më së mundij  
të shërbej e kish të gjëllij  
me limozën, moj së tundij  
se me penë kurmin e tij. 40  
Vej tue lipur nd' ato shpi  
e ja jipëjin me duani.

Sa kërkoi, ai mbero  
më se lipsej prë një dit  
nëng i lipij, e kjo 45  
bëme u xu e nganjë prit  
herën e tij e nëng mangoj  
se të i jipij sa kërktoj.

Ndo me nxërr e me diri  
e përzëjin ndonjë herë 50  
(e ng' e bëj se ghrell njeri)  
së hejmohej pjaku i mjerë,  
moj me gaz e pa rëkuor  
gjetkë venej tue bekuor.

Ndonse piejin se çë kish, 55  
nung e thoi kurraj, e vet  
i përgjegjej se kur ish  
trim shëndosh e i ri ndë jetë  
thomse bëri ndonjë fëtesë  
e nani je qaj e besë 60

kish të madhe se Perëndia  
ja ndëlej e prësandaj  
i dërgonej metania  
posi lule çë kurraj  
.....sa mbëshon 65  
një mbëkat kuj e kujton.

Kur ndë diell e kur ndë hje,  
porsi lipsej e hjesohej,  
djelëmit i vëjin re  
e nganjë i afrohej: 70  
e tëfalëjin e për nënë  
gjith i ujçin tuke thënë:

"Se ti, lal megallos,  
nëng na thua ndonjë përrallë,  
ndonjë stori o ndonjë këllos 75  
çë pendiksën, çë bën valle  
me të sajat polloqidhe  
çë kanë tarrin në cimbidhe?".

Plaku qeshij ëmbëlsisht  
e i thoj: "Arrut nani  
se të bëni hajdhisht  
ca rrëmurë e bredhmje ati?  
Ndose duoni të ju thom  
gjë, kin rrini qet e njom".

80

"Dhja si valt ndë ranxhele,  
si ndë zëmër rri spërënxa  
e si hit rri ndë koçele  
rrimi na, ndose rrëmënxa  
ti na thua nga ato çë di,  
se na bëjin triëmbëlsi".

85

90

"Dini ju se çë pësoi  
një djali ndë një mot  
pak i lart, se së vështroi  
mirë të jëmën?". "Jore, zot!".  
".....ku ai  
ju e rrëfienj këtu nani.

95

Jëma i thoj: "Mos ec me Nxhikun,  
se të liga të porsin;  
dardhën, kumbullën e fikun  
mos ja ngit njeriu. Ndë hin  
ndë një kopsht se të shkoç  
pemët mëngu ke t' i ruoç.

100

Me Kolluçin çë pi verë  
mosnjë mot ti u përziej;  
se të veç me të di herë  
ndë katoqe, mos më piej  
çë mund vinj të keqi tij  
më se nëng i arruri atij.

105

Me këto djejm çë mallkonjin  
e së dinë të thonë një fjalë  
dreqësisht e mos turpëronjin  
posa shohën, si, me val  
e përzier, me pjëh e hi,  
zbukurohet një stoli,

110

ti, biri im, mos u bashko,  
se këta janë si pësora  
cila ngjitet, dash o jo,  
kur më e të tiren ngrohet dora.  
Të mëdhenjve më se ti  
mos përgjegj me nxirr, e di".

115

120



Thoj këta e aq të tjera fjalë më të mira nojtesha jëmë të birit, ndë gjith hera Moj ai, si gjegjet mesha .....rrij vet me tru ndë bëgatëri.	125
Gjegjij e ng' i vënej re, more bëri shtrëmbërisht sa i porsiti ajo me hje shumë të mir e dashurisht. Moj pëstana ç' i pësoi, kur të jëmën së ndikuroi?".	130
Thanë ata: "Atij ganjun?". Ndjeku plaku: "Rrukullisi, pa u qëndruor kurraj gjikun! Ka një vix ndë nj'etër udhisi e nga mali vate ra ndë një gropë çë sjetë së ka.	135
Keq u nxi e lig u bë: zëhej, dehej e mallkoj, haj e pij, e ndo së kish gjë, tjerëve mirrij e kalloj; mbë serpos u bë banit e dhuroj Pushtjer një vit.	140
Vritij njerëzit e i xheshij sido të ishin, të bëgetë o të nëmur; vrit e qeshij, e harepsej se ai vetë gjith katundi bën e dridhej e njeri së ghuxoj të i hjidhej".	145
"Moj ç' i bëtëtin mbë serpos?" thojn djejmët të hejmuor. "Kado bëme ka një sos. .....këmbë e duor .....e zunë e ndë filaqi e vunë.	155
Njohtin lexhën e njinje e dërguon të disij vjerrë. Mbjatu e vuortin e atje lanë se të ish ka zogjt i shqerrë. Gjakun qentë i lipitëtin, prana eshtrat i përpitëtin".	160

"Bjerrafati!" thirrtin gjith  
 të tromaksur djejmë,  
 "qelli dëmin dhja ndë vith 165  
 çë kur leu e hejmit.  
 Ndë rrëmënxat çë na the  
 më kjo na bëri tre!".

"Ju porsiftit e ju bëtë,  
 si ju duon prindit e tëjë,  
 mir zakonin, e ju lëtë 170  
 prë lipsi fanmiri tëj  
 mos të bini ku ra ki,  
 çë rrëfieta, fatizi.

### 31. Karroqari

Ish një prift i holl e i gjatë  
 ndë një katund e avarun,  
 çë së lëj ndonjë menatë  
 të thoj meshën ku gjikun  
 e sa më mblidhij turren 5  
 thoj se s' kish, e jipij bes.

Kish të vjetër një sutan  
 .....të shqerrë  
 .....mbënjane  
 sikur t' ish ndë kuje vjerrë. 10  
 Kish të arnuora ca këpucë  
 e të trasha sa një vucë.

Ngë mënoj mbero ndë shpi  
 vet një kred e vej e vij,  
 tuke sjellur dhe e hi, 15  
 si bëleta. Nëng pushtij  
 mos të grisij vetëhenë,  
 e haj buk vetëm si qen.

Kish një shtrat sa një paidhe,  
 të pështruor me një pajacë 20  
 gjith e arnuor, si një stafidhe  
 zezullore, e gjer di brac,  
 tri je gjatë, e ndën një thes  
 çë vlej mosnjë shërbesë.

E për aq ati pushoj 25  
 posi guri ndë putril  
 të një ronxi. Ngë i qëlloj  
 shumë mbero, se mbanej ndë il

ca murriza shpojtare çë ng' e lëjin fare fare.	30
Kin kujtuome çë ndë tru sembre i vejnin, se njeri mund i vidhij, e ndë gju, çë prëhapej prë ndë shpi, mbaj të lidhurëz një tërkuzë e ca fosfoj prë ndë buzë.	35
E bërë nëgoxë pa stjende .....të kish .....gjith vende. Me këdo gjënde, kudo ish, fjit nga ato e sembre thoj se të mira ning i çoi	40
posi lusij; e ndë qënqe ng' i rrëndojin e ndë leshe si të tjerëvet. Ndonjë skamënqe vet i bëjin, e ndë deshe s' kish furtunë. Pra ndë djath bënej aq sa e haj me bath.	45
Thoj ai. Po shtrëmbërisht vej shërbesi, e një'tër çerë kish, se ai buftoi me bisht burrin çë ka vithen e gjerë. Vate ndë qishë një dit t' e thoj meshën e delezit penxoi.	50
Sakristani kur e pa e tëfali. Pa mëri ng' i përgjegji e i tha: "Ç'ka imi dash çë keq më rri?". "Thomse ka ethen të verdhe e ndë krie të boçka herdhe"	55
i përgjegji sakristani. Prifti nëng i vuri re më se poçes vë ti[g]lani ndo të zienjën bashk le-le. Vate u vesh e ndë lartar rrij si thoj meshën e parë.	60
Një thërrimes mbarvalisej .....thoj .....e nisej e pometa prirë të e thoj.	65
	70

Moj së munda me atë penë  
të mblidh trutë mbë vetëhenë.

Ëndërrri thomse të kish vatur  
ndë një markat të shitij gjë  
e tue shitur e tue ngjatur 75  
shumë kuntratin më e më,  
më u harrua çë bëj, ku ish,  
ndo pushtjer, ndë shpi, ndë qish.

Për të marrurin adet  
meshën thoj çë kish ndë mend; 80  
kur u pruar të thonej vet  
parkalesën ndë këtë vend  
"O vëllezër" - i tha ai -  
"imi djath ka di karri".

"Ndo kush të e paguon ti gjën" 85  
sakristani ju përgjegj  
"një nigox trimirë ti bën!".  
Gjindja çë ish meshën të gjegj  
nje lëshuonë një gaz i gjatë  
e më bën një rrëmuratë. 90

Prifti u adunar e nje  
me tri fjalë meshën mbaroi.  
Çë -n- ahierna më së qe  
karroqar, pse ndigoi  
se ndë tjerët ki vix më nxinë, 95  
djeg e grisën si kaminë.

Ndose arrurë ka një herë  
një mirakull posi ki,  
.....gjer  
..... 100  
moj pse vixet ghuerçonjinë,  
zotruan e zotëronjinë.

### 32. Vidhjujza

Qe një grua një herë e gjallë  
cila hëngri e piu si ani  
hanë e pinë e ndienjin mall  
gjith sa janë mbi dhe; moj ki  
ngë është shërbes vërteta i ri 5  
cili të ju bënëj cjudhi.

Moj cjudhi pa ëh e jo  
mund të ndieni kur çë xëni

se kush qe, çë bëri ajo:  
hapni sitë andaj e vëni  
re në gjasmën çë ju bënj  
ndo të e marr si qe t' arrënj. 10

Kriet e kish si kungulloth,  
ballt i zi e vetullat  
me ca qime si qemboth,  
të golasme tëmbëlat,  
veshtë e gjata e mallëzuome,  
cinërat mbë një të shtuome. 15

Kurmin kish të likshtullor,  
misht i trashë e pak të zi,  
kish të gjataz ato llor  
e si maçja ruon një mi,  
ruoj kur frinij e përdridhij  
qafën e gjatë e faqen mblidhij. 20

.....zënë 25  
.....  
dhja si dhia vej tuke bënë,  
ndo të ecij e të flit,  
lia çë pati gropa gropa  
çerën i bëri e copa copa. 30

Me këdo piqej vet një her

[.....]

Un'edizione delle *Satire* è stata curate da Carmelo Candreva e Gjovalin Shkurtaj; F. A. Santori, *Satira*, Dituria, Tirana 1998.  
Il titolo santoriano va letto *Sätirat*, secondo la pronuncia italiana.

## RIME SPARSE

1.

- a. Ng' është e larte thavmasī  
se pilloti te proiti  
shokëronë një madhe anī,  
cilën dejeti nëng e shtriti  
se me hollez një puhjī, 5  
cila tuke bredhurë friti  
ans' e pups nd' ato sqep.
- Urtëri buftonë e art,  
kurë mbi dejte të prëthella,  
tuke vaturë posht e lart 10  
mbi suvala e llaka thella,  
leze aninë e siell i kart  
te proiti, tek ë gjella,  
po si djelmat prë ndë djep.
- b. Nuk buftonë urtrinë çë kã 15  
një pilloth ndo se shokonë  
ndë proit një bastimend  
kurë mbi dejtin sheshullorë  
pa suvala e terëmonī [pa suvale  
t' e sërkonjë lë kush e do. 20 [sheshullorë sërkonë si do
- Moj ndo bie ndë ngushtin vã  
një tembestje, ç' e rrëvonë  
pa pandehjurë ndë njëmend  
e ai me shpirt mbë dorë  
dreç sallvonë të tijjën anī, 25  
është mirakull, ëh o jo?
- c. Nëng buftonë sa njeh e dī  
një pilloth te moti i mirë,  
kurë mbi dejtin të dulirë  
me të huoja bëgatrī 30  
shkonë suvala sheshullore,  
e me varkën rëndullore  
hapta sqepe hinë ndë port .

Moj ai vërtet zbulonë dijtunī e zëmërë dreq, çë ndë mest një mot i keq me suvalat lufëtonë. Llaka uji, skole e male s' ndikuronë e shura e zale: shkonë e vete i tërë ndë port.	35      40	
d. Nëng bufton sa njeh e dī një pilloth te moti i mirë, kurë me vaturë të dulirë mbi suvala sheshullore shkon përpara, e rëndullore varkën qellën ndë proit.	45	
Moj aī buftonë urtrī çë names një mot i keq larta pret suvala, e dreq fjutoronë male mbi male, lufëtonë me skole e zale, si ndë nat edhe ndë dit.	50	[pa t'e mundinjë t' ujet dira [e këndonë se nëng u mbit.  [ pra këndonë se nëng u mbit,
2.		
Ngë thua të rreme,   ndo se vandone, se me shkëlqeme   kush jē buftone. Ngë shehën dhoksen   çë meritove, kurë çë luftove       Turqish tri zet.		
Ti shpatën luojte   si shkepëtima, trandakse zëmërat   si bumbullima. Mbi njerzit vajte   si her' e keqe, si zez vëdeqe       çë merr sa nget.	5	merr] hā
Sa ndodhe shqore,   me shpatën preve arënxa e hekurë   e nëng lëreve të tëra eshtërat   kudo rrëvove e truollin shtrove   me copa mish.	10	
Gjith i kondrepsurë   me gjak u prore, lionë çë thigritë   luftove e shqore. O mirë i ardhurë   ti qosh ndë nē, formadhe hje       të shējtes Qish.	15	

[Gjith i kondrepsurë me gjak u prore,  
 [ me çerën e dirëme, jo të ndërrorre,  
 [ si kurë me thigrin lioni u zū  
 [ e bën' e xū sa i vogël' ish.

3.

Më ndjet se bënurë prë mua ti qeve,  
 vashëz e bukurë, çë dreq u leve  
 përpara derjes, gjitone mua,  
 formadhe grua çë më gëzonë.

Me gol të qeshëmez, me sī të gjalla, 5  
 me faqen kuqez, të pjonu malle,  
 me njomën zëmërë e bardh si bora  
 katunde e hora ti zotërōn.

4.

Ashtuposht qeshën gjithia:  
 ndë kto male, ndë kto sheshe,  
 prej një kroi ku është ambnia,  
 me një gjellë të rē ti veshe.

E sa ruonë, sa sheh të zgjōnë 5  
 dreq ndë shpirtin një harē  
 madhullore e të zgjerōnë  
 ndë krahnuu mushkrinë, nd' e kē

të kërrusurë e pa frimë.  
 Vet kjo, vetëm kjo 10  
 keq na ngosën me gëzim.

5. a

[Nga] dēm, çë na kanosën  
 e na shtëfrosën të vinjë mbi mē  
 [ll]argut me lige çerë,



ndo se të jēt' i thirrurë  
rrëvonë me trë 5 v. e.: rrëvonë i nxirrurë  
e dëmin bënë të thellë e më të gjerë.

Andaj neve na lipsën  
[të] mos penxonjëmi  
dëmin që mund na vinjë,  
[se edh]e liga vëdeqë, 10  
ndo nëng e njohëmi,  
[gj]ellën na pret e s' bën' e kemi ghrinjë.

#### 5. b

Ndë gjith dëme që kanosënjin  
keq të murgëthin njeri  
është vëdeqja, e kush ng' e dī  
sa mbëshonë mbi gjith kjo? [më se gjith ndo e turpurë është  
[moj ndo mend ng' i lakosënjin

E vëdeqja, edhe ndo priturë 5  
vjenë, buftonet brute keq;  
moj, nd' arvonë pa diturë dreq,  
është e ëmbël shum' ajo.

#### 6.

Nëng arvoi njera ku deshe  
se prë nd' udh e mbajti ai,  
kurë nxirrepsurë u përqueshe  
keq prë dirë e madhe ti.  
Se t' e vrisënje nëng e munde, 5  
moj prëthellë keq e sëmunde,  
sa gjëllinë e nëng gjëllinë.

#### 7.

Qeshëmi, vashaz, me harë!  
Juve qeshëmi pri s' kundrela,  
qellëmi lodrën pjono hjë.  
Po si pulat ku janë gjela,  
mbashken mbjatu vasha e trimi, 5  
po si qatëri e tëtimi, ms: të timi  
vapa e dielli që shkëlqenë.

8.

Buka e bardh e moti i mīr  
nëng varesen ndonj hēr.  
Semre hahen me pjaxhīr,  
si ndë dimër ashtu ndë vēr.

Siu i zī, shkëllqēm, dëlīr,  
gola e kuqe e pak je gjēr  
të rrëmbenjin, si rrëmbën  
haraksia çë zbardhën dhën.

5

9.

Ti më shtridhe ndënë paidhe  
si një zog çë s' kã fëtes  
e ndë liga të përliga  
bën e pata madhe pjes.

Ndë dhurime e ndë lëngime  
pra të shkreturë më lëshove.  
Ti më shtite e më kërsite  
pa lipsī kudo më çove.

5

Ni më vjenë përpara sī  
si një çerë çë vrëjturë rrī  
e namurë më lipën e mallë?

10

S' kamë një zëmërë më të detë;  
moj, nd' e kishnja ndë ktë jëtë,  
lënja më të vej me djallë.

10.

Ndējme, ndējme ti atë dorë!  
Via, shtrëngoje dorën time  
të fëtohte e keq të brime,  
si njeriu çë rrī të des.

Moj ka jotja zjarrullorë  
del një zjarr çë hinë ndë dellë

5

e ndë gjak arvonë prëthellë  
te kã zëa më mirën pjes.

Nd' eshtra shprishën ahiena mua  
doqullore një fuqī, 10  
çë më ngjallën e bënë të rī,  
më se shiu lulen ç' e pret.

Këtë hirë je vetëme dua  
prë nani duanisht e dreq,  
cila ng' është e madhe keq, 15  
se pra jetrat vinjin vet.

#### 11. a

Cinxërrisën cinxërra mbal  
tek ulliri me harë,  
kurë delmeri fjë ndë tal  
i prëngjaturë ndë një hjë,  
ku rrinë delet ndë mëriz. 5

Kardhulliqja mbi një lis  
ndë një deg e lart këndōnë,  
borëza mbi qeperis  
bashk me pasarin lodrōnë.  
Ndallanisha gjënë një miz. 10 [Ndallanisha fluturōnë  
[pas një blet o pas një miz.

#### 11. b

Cinxërrisën cinxërra mbal  
deg ulliri me harë;  
prë ndë lule gjënë mjal  
bleta, e delja rrī ndë hjë  
prej delmerit ndë mëriz. 5  
Milingona edhe shërbenë,  
kurë kallandra vete vjenë  
o ndë pandkë o ndë murriz.

Kardhulliqja mbi një lis  
bashk me borëzën këndonë, 10

ms: cinxa

pasari mbi qeperis  
doq thërret e strepëtonë.  
Ndallanisha hapta krah  
lodërönë tek ajri i gjerë  
e sqapari tue fishkllërë 15  
bënë si shokën do t' e rrah.

[Ndallanisha nd' ajrë i gjerë  
[vete e vjenë, ndo të përpjek

12.

Kūr shëroku zotërön,  
vëñ një hëll mbi qeramidhe  
të rrjër si anemidhe  
për alartaz, e të qërön  
ajërin të rënd çë vret 5  
gjith sa rrethullön e ngët.

Ndo mbi tries o prë ndë shpī  
pak të derdhet o shum' vër,  
mos hejmohu. Ng' është i zī  
kī nishān, po është e gjër 10  
dër hareje, e mīr të vjën  
çë të prodhön e të pëllqën.

Valët, ruhu, mos e derdh:  
hejmi e lipi është sinjäll.  
Gjebërin e bën të verdh 15  
e të nxīn ndë zëmër e bā[ll],  
të cënön e të kondrepsën  
e ndë keqa shum të zepsen.

Djal o vashëz çë t' u lë,  
mīr kufī e vëri rē 20  
kūr të thët të parën fjal:  
ndo se atin të thërret,  
rrön; ndo emën, ka kjo jet  
shket më nje se nd' uj një ngja[ll].

Ujqë e gjajpra nd' ëndërrīm 25  
t' u fanestin e të trama[kstin]?  
Ndo se munden, trëmbësīm  
mos të kēç, se prë nd[ .....]  
së të vjën të lig[u gjë]  
ndo sqëlluor gjëllīn o fjë. 30

v. e.: trëmbtin  
ms: munde

Tilighadhīn e pramendën,  
çë kån kriqen, teku fjë

mos kumbisi, mos ndë mendën  
të rrëvōn të ligu gjë.

ms: nga

13.

### K Ë N Ë K Ë

O bubuqe bardhe e kuqe,  
fanëmira ti ndë lule,  
bukurinë e mirudhënë  
kuj ja more e kuj ja shkule?  
Majde! Mali të lutōnë,  
sheshi e llaka të kërkōnë  
t'i nderoç e bukuroç.

5

v. e.: te barere t' i nderoç.

Gjelbërinë e kalthërinë  
qielli e dejeti bashk t' e dhanë;  
verdhullore e ohjistrullore  
më se ti tjera së janë.  
Të kâ bënëurë haraksia,  
ilëti e dielli, e tas gjithia  
të dërtoi e të pastroi.

10

Dranofile e bardha lile,  
shtupagjele e monosaqe,  
sa ndën ile janë kopile  
me kojllorëta e holla faqe  
fare fare mun të gjasën.  
Afërë tij kërrusen, shkasën,  
po si ngjala shket, nd'e nget.

15

20

v. e.: po si ngjala shket e nget.  
v. e.: po si shket ngjala, nd'e nget.

Thomse Zoti kurë qe moti  
çë të bëri, gjith ndë dorë  
kish harenë, ëndën e rënë  
e mbi tij e mbrazi e nxuori.  
Moj vërteta, sa ti shkonë,  
mose gaz [e] mallë mburonë,  
çë shtrëngonjin e thëronjin.

25

Ulet bari, ngrëhet ferri,  
sheshullohet udha, e gjëmbi  
humbet, e beisën shtjerri,  
sa të sheh, qëndronë katrëmbi  
i cjudhiturë, e mbi deg,  
tek një mollë e tek një sheg,  
zogu të të ruonjë pushon.

30

35

Corrobil, ghanjünë e vasha,  
trima, pjeq e burra e grā,  
cilatë qënë e janë te dasha,  
të lutonjin; kush do kā  
zëmërë mishi e prifti edhe 40  
të nxierë shapkën më tutje.  
E këllogjari çë bën?

Ni penxoje e mirë kultoje  
ndo se mua ndë gjī, ndë trū  
një dhishrīm e një shërtīm 45  
keq i dhezurith m' u vū  
të dëthinja nd' ato fjeta  
ku je rē më bënej jeta,  
një njëmend pjonu kutjend.

14.

#### K Ë N Ë K Ë

Jo më, jo më te zëmëra  
çë lē ti mos u prirë.  
Mbanë ti se është e bukurë,  
si qe një herë dulirë,  
kurë gjith i qeshij gjella 5  
si lules, çë te qjella  
të shihet e gëzon.

U veshk, u veshk e mjereza  
si barë, çë uj së pati;  
vapa e prëthajti, e rrëmbatë 10  
mbi të ka qiella ngjati  
dielli; me nxërr e ngau ms: nxurr  
punendi e gjith i vrau  
hirin, çë m' e nderōn.

Nani gjith e kondrepsur, 15  
si pëmë çë lartit rā  
te balëta, atje lëngonet  
e mallë e ënda s' kā ms: unda  
të ngrëhet, o fuqī,  
ndo doj t' e bëj, e rri 20 ms: rī  
po ngrisuren të pres.

Çë pret ni ka kjo zëmërë  
e rārë e je ndërruorë?  
Namurë së ndienë, së gjegjën,  
gjëllinë po si e harruorë 25  
ka gjith e gjith nodhjōnë

sa ruonë e sa kultonë  
se qe o është nani.

Gazin e zbuorë, që ngjallënej  
vëdekurit, ndo duoj, 30  
ndë sītë, me kë harepsij  
këdo me mällë të ruoj,  
nani monu përlotënjin  
ashtu po të kullotënjin  
dëmin që pati ajo. 35

Si vate, vate. Nj' ëndërr  
u mbanjë se qe kjo gjellë,  
linarë ç' u dhez, e i shuojturë  
që ndë njëmend, e u thëllë  
nani ndë faregjë, 40  
ka cili s' thuhet më  
se pak prëndriti o shum. [e, dreq si uj që mbrazet,  
[u zbuorë te dejeti i thellë  
[se sheshevet dheishte  
[të bënavet njërishte  
[së thuhet pak o shum.

15.

#### K Ë N Ë K Ë

Popo, vash, sa e bukurë jë!  
Më dëthinë me ato sī  
e ai gazith që ti kē  
gjakun tilqën e m' e pī;  
e ato vëraz, që ndë faqe 5  
kē si kuqez monosaqe,  
keq shkëlqenjin e rrëmbenjin.

Shumë kësheti të ka hjë  
e të pjeksurë lesht' i zī  
me atë hjetullez të rē. 10  
Gjet rrubinit, kurë që rri  
mbal një lule ku s' pushonë,  
e për' aq ndë të kërkonë  
ëmbëlsinë ç' e gjëllinë.

Bëshëmi gjī e holli mes 15  
me të bardhen linjë të mblirë  
të buftonjin si shërbes  
qiellisht i pjonu hirë,  
e ajo kalthërë xigharele  
çë të ngjeshën, je pushtjele 20  
me një çof si një karçof,

tuke fllushur, si një pend  
ç'është e vjerr, mesin të bëjë  
[Vete nd' ajrë e lez e lez  
ms: më

mbi kandushin si mbi shesh  
ka ti shkonë o rri, po gjë  
një puhji të hollë të hollë,  
çë t' erisën faqen möllë  
ni këtej e ni atej;

25

[e nd' atë vend, [fillushën penda

e prë nënjë një mirudhirë  
shprishën e ëmbël, çë shëronë  
të sëmürmit e dulirë  
bënjë nxirrepsurit e zgjonë  
ndë gjith zëmëra një namurë  
çë ng' u ndie mbi dhë çë kurë  
jeta qe e më tutje.

30

35

Thuojme, thujme ti ku leve!  
Leve Llungërë o Spexānë?  
O ka Ghreqit erdhe neve  
të na qëllnjish gjith mbatān  
me trilarthen bukurī,  
me atë fōrë e madheshtī  
çë mburōnë sa më e zbulōnë?

40

Qoft' ashtu, qoft' ashtu!  
Neve pāsh ti lipisī  
e mbi gjith po ruoj këtu  
mua të murgun e të zī,  
çë këndonjë si zogu mbrēnda  
ndë kanxhele, jo për' ënda,  
moj prë nxirr rri tue thirr.

45

rri] t. e.: jamë

16.

Sa mīr të desha, sa mīr të dua  
mos [ng'] e ndijgove njera nani  
buftōn vërteta se së jē një grua,  
se maj ndë zëmër më mbajte ti.  
Qeva ji llavur ç' e pata bes,  
jam i pa trū ç' e kam edhe.  
Ti je një grua pjote gënjes,  
taksën këtu, staksën këtje.

5

17.

[Prë të lerën e Krishtit]

O lefterōr' i gjithëvet,  
i bër më pār se drita  
ka madhi Prind e gjasëm  
Ātit si dit me dita,



tit Ati ti shkëllqemja  
mburuome ellpiz e hjë,  
po gjegj nani si truh'jen  
sa njerz të dñn, mbi dhë.

5

O Zot, çë gjith shërbiset  
me dorën tënde i stise,  
kujto se ti nga Virgjëra  
u leve e ndë në vise.

10

Kjo dit çë vete e priret  
ka vit na kallëzōn  
se ti, ka qielli nisur,  
ngjallën shëndën e mōn.

15

Tij dheu e dëti e ilëzit  
e sa ndën qiell gjëllin  
këndonjin e tëfalënjin  
si lefterori jñn.

20

Të lumët na, t' potisur  
me tëndin shëjt gjak,  
tëndën të lër këndonjëmi  
me mäll çë s' bënet pjak.

ms: nat

Jesu, ti pafëç dhokëse,  
çë tas ka Virgjëra leve;  
me Atin e me Shpirëtin  
qofç' i bekuor si qeve.

25

18.

K Ë N Ë K Ë

[D E Q J A]

Vetëm i vet e i hejmuor  
diu çë venja tue penxuur.  
Afër vates ulur rrinja,  
drunje e ūr te zjarri shtinja,  
e si prushit bënshin hñ  
ruonja me jo pak cjudhñ,  
e si grisit gjithësej  
lart e posht, këtej e atej.  
"O, si Deqja është e zonja  
nga gjithia!" u i murgu thonja.  
"Si ngë mbjohet ajo grop,

5

10

[Nga nj' penxjër ndë nj'etër i vatur  
[e më rënd sejën tue matur,  
[ruonja faqen si ndërronjin  
[bënat, çë ndën sñ na shkonjin,  
[e si priren e si grisen  
[e si ngrëhen e hjimisen.



se tue vatur prë ndë mot ndonj djall o shpirt e pã, o të vogël o të mbëdhã, çë ju duk, i foli e bëri mîr o lig. Ata ti vëri ndë shtrënguome, e mîr kërkôn sejën, e thënurën thellôn. Thuaj: Ndër aq mijër vjet ajō udh si nëng u gjet? Si ng' u pã e nëng u xū ku mbarôn e kaha zū? Nd' është e ngusht e nd' është e gjër? Kush [kã] këmb të vinj, të vër prë ndër të, me cilin pas kã të shkônj, të vër, të ngas, pa të bjër o të qëndronj e ndë fin të mos t' arvonj? Si ndër miq e ndë gjëri nëng u pruor kurraj njeri se të flitij, të levroj [prin]d o bij e të shëroj [ata të mjër çë ] qëndronjin [edhe zëmërën] e cënonjin [tue penxuor se] mëngu moti [t' i levronj] pra është i zoti!? Si një [hër një] shëng, një kãrt ng' i [dërg]uon t' ëmbëj, të thãrt, si do t'ish; mbero të thoj se të shoqes ja dërgoj [..... vje]tër o të rë [.....] o kolloghrë [.....] ajō mënôn [..... ]usën e je kërkôn [tu]ke qajtur nat e dit çë nga një te jetri vit!? E njeri murges ng' i vjën më se hejmi e saja pën! Me sa lot, me sa hjidhî, me sa hejëm e uratî birin dashur ng' e thërret ajo jëm qëndruor je vet? [E ai] jãt çë një llojë bijshi kish e ani mbi dhë s' kã më jetër se vet'hën pa fuqî, e njeh se i vjën ngrah e ndëndëte nj' errësîr, çë je shtîn edhe pa hîr se të qanj e më ngë kã lot, se kroi i lotve u thã? Sa harë e sa pëllqeme	65 70 75 80 85 90 95 100 105 110	[Me fjal o me jatrî [o me t' errëta strigharî [o vetëjuji o të ndonj'etëri [më të dijmi e të vjetëri [magh i fôrt e lidhëtâr, [ngandatâr e rremëtâr. * v. e. [o pësuome pa u pandehjur // [ Një e diqind e mil milljune [ qën pa sî e kotikune?  [Si një hër qën të thërritur [ka ndonjë e u pãn të pritur [pra nga shùm e shùm, të shurdhur [u qëndruon e drej të ngurdhur!  [ç' e përlosën e je përripën [e fuqîn e gjellën i shtipën!
--	---	--

sīt këtij, ndo se hareme  
bil o bīr i fanarosej  
t' e lëvroj një kred e strosej  
pra të vej e vej vërteta 115  
tek e thirrij ndrishe jeta!  
Vān mijare e mij vjet  
e kjo dēr kurraj u gjet.  
Se të vën e gjënjn gjith  
si kaluer ndë [.....] vith: 120  
e pa ecur e mbë këmb  
tuke vatur, e pa dhëmb  
pjeq, e djejëm e kërdhij  
pa u lër e corrobij  
ndrishe shortashi; e vuvosen 125  
gjith e gjith te gropa losen.  
E të pjejtur, si ngë gjegjen?  
E të thirrëtur, si ngë përgjegjen?  
Jo, ngë folëtin e ngë fjasën  
e, të ngār, gurit i gjasën 130  
i pa skis; ashtu ata  
rrīn ndë vend ku Zoti tha  
se kār rrīn. Ai çë bëri  
tas gjithīn e mīr e tëri  
me trilarte urtērī, 135  
vetëm ai, ai vet e dī.  
Moj ndo na keq e kërkonjëmi,  
vjen m' u thēn se e ndijonjëmi.  
Mos nëng ish, ng' e duojin fare,  
nëng e duojin lipisjare, 140  
nëng e pritjin gazullore,  
nëng i trëmbçin se dirore  
[na] thërret të na hejmōnj  
o me mīr të na vajtonj.  
Vjet përshekūon qind e mijare 145  
e ajō dēr ng' u hap fare.  
Anxi, me nj' mīster të thēll  
pa ndijguome te kjo gjēll,  
është e haptë e je mbu[llīr]  
për të ligj e për të mīr, 150  
e strahapte ndë të hit[ur],  
ndë të dal fort' e [mbullitur].  
Se të vën, tas gjith e gjënjn  
e mē hinjin, mē anxënjn.  
E një mik e një gjērī 155  
me sa māl e sa hajdhī  
shihij mikun e gjērīn  
di o trī hēr, mē pār të vīn  
hera e tij, e me harē  
nisej prana nga kī dhē. 160  
Ata eshtra të trazuor

[aq milljune corrobij,  
[aq pa lër e lër kërdhij,  
[aq të dekur pjeq e pjake  
[prë ndë sheshe, male e llake,  
[ndë përronje e prë ndë tropa,  
[o mbi bot o prë ndë gropa.

si ng' u ndajtin tue rëkuor,  
 kūr ka një ndë nj'etër v[end]  
 i kân qelltur të skutjen[d].  
 S' kân këta më zëen e tire 165  
 të përgjigjur, e zinxire,  
 leqe e gjajme i shtrënguon,  
 si ndë gjëll ndë pak çë rruon!  
 Gjith u zgjidhtin e u çajtin?  
 Mos ndonjë të tër e mbajtin? 170  
 .....  
 aq e lusëmi e dishëronjëmi,  
 vjën me u thën se është vërteta  
 tej mbatân, po ndrishe jeta.  
 ..... 175  
 .....  
 prë një hër çë zë e ngë shkōn  
 e është e thënur Stoneōn.

19.

[A G Ë Z I M]

Mbjidhemi, trima, mbjidhemi bashk,  
 po si vëllamëz të zën ndë Pashk.  
 Këndonjëmi ëmbël, këndonjëmi mīr,  
 japëmi njerzëvet, neve pjaxhīr.  
 Këndonjëmi udhavit pa ngār njerī, 5  
 pa bënur dēme, lig o keqī.  
 Mbero si trima të rī çë jemi  
 një mäll te zëmra kanjë m' e kemi;  
 po të mbullitur e mbami e qet,  
 e zëmra gjegjën, ç' asaj i gjet. 10  
 Po na ngë stesëmi, ndo se njeriu  
 i tundet gjaku, i dhezet gjiu  
 e, ndo buftonet ndë dritusore,  
 merr vesh e gjegjën një t' ëmbëlore  
 zanje ç' e tundën e të shërtonj 15  
 zjarrisht e shpitën e të kërkonj  
 të shoh të dashurin nd' atë llojë  
 ndo se këndōn bashkaz me nē.  
 Na shkomi e vemi tuke kënduor  
 e lusëmi njerzit të jën gëzuor 20  
 me gjith të mirat çë mund na jap  
 e dheu e qielli, si duomi, vrap.  
 Shëndet ju lusëmi, shëndet ju thomi,  
 bukën e verën ju agëzomi  
 të mos ju lër, mos të mangonj, 25  
 sa ngjatet gjella, sa dheu të rronj.

I lusëmi vashavet një dhëndër i but e të martuomevet bil me kustrut çë të m' i rriten si qeperisi t' ūrt, e hjemadhëra si faji e lisi,	30
të mīr, të fōrt, shërbenjētār, sa të ndërronjin guret mbë ār. I lusëmi pjeqëvet një qind vjet harēm t' i shkonjin e me shëndet, e pra të bënjin një t' ëmbël deqe	35
pa një dhëmbin e pa mos një keqe. E nikoqirevet nd' ato fëmila po të duarisnjin kukule e lila rrëgjēnda e t' arēta. Djelmat edhe	40
të bredhën pak, të xën për tre; nderuom të rriten, të bënjin hjē, të jēn të prindvet gaz e harē. Ni çë katundin gjith e kënduom, trimat e vashëzat i agëzuom,	45
nuset e dhëndërrat edhe tēfalëtim, ghanjūnt e djelēmat laudhuom e mbalëtim, u adunarëtin se nata u thëll e duan të fjënë njerzit ndë gjëll. Andaj na priremi ndë jonat shpī e lēmi gjithve paq e pushī.	50

20.

#### S T R A M B O T E Z

prë të rrimosur ndë katund o gjetëk

Na, si burra e grā çë jemi, tue kënduor ku të vemi? Vemi prë ndë gjitonī e ndë miq e ndë gjērī, e me gjuhën çë thërret	5
falēmi njerzit si na nget. Ndo se zgjonjēmi ndonj māl, qoft' amuri ai sinjāl. Na ka udha thomi gjē kuji ē zgjuot e kuji fjē.	10
Ndo nguallarēmi e kemi hjē, mirrni vesh e vēni rē. Ndo pēstaj sē vemi mīr, mblini veshēt e rrini mīr. Mbēt me jū ji ëmbli gjūm e shëndeta e paqja e lūm.	15
Hejmi mos ju ngāt kurraj, jo të qajturit, jo ghuaj. Pafçi mīr e gjate gjëll,	

prë sa dejeti është i thëll.	20	
Pafçi aq bëgatëri, prë sa shūr te zalli rri.		
Ndo na hapni, hinjëmi mbrënda e këcenjëmi bashk me ënda.		v. e.: e këcenjëmi ndë të rënda.
Bredhëmi si na nget me hjë e lodronjëmi me harë.	25	
Sonde ç'ë ki Kalivār, mīr mbrëma, ju bulār; ju bulār e bularesha, e ju gjind çë thoni mesha.	30	
Burra e grā, sa ndë ktë vend jini, qofçi gjith kutjend.		
Pafçi vjet, sa fjeta kā qeperisi më i mbëdhā; sa pik' uji jān te kroi e sa penda kā paghoi;	35	
e, sa sī tek ai bisht, hira bëftit Zoti Krisht, po si juve, bilëvet, mbesavet e nipravet.	40	
Rrofçi sa më rroi Noeu, e, si ai Zotit pëllqeu, i pëllqefçi ju edhe njera çë të veni atje, ku me pame ai hajdōn kë do mīr, për mōn e mōn.	45	

21.

Zonjës tēn  
**ELLENËS GJIKA**  
 Pringjipeshe t' Arbënīs  
 prë t' agëzuome të vitit së rī 1870  
 Frangjiskandōn Sandori  
 dërëgōn këtë  
 K Ë N Ë K Ë Z

Qën di Lena, ti je e treta.  
 Shkoi e para si një zjarr:  
 tas u gris, mallkuome vate.  
 Rā je dita edhe ndë varr,  
 moj mbi dhē na la ndonate  
 keq të lārëte, se nga trolli  
 Kriqja e shehur bën e dolli.

5

Ni mbi tij ruhet e shkreta  
 Arbënī. Çë të vëlēn

se me ëmërin çë ti bëre 10  
qiellin mbjove e mbaru dhën?  
Ndë kurōr ni fjetën vëre,  
ç' i mëngōn të jët e tër,  
si ato jān te qiella bër.

Tij si nd' ill të haraksīs 15  
ruon e truhet, dhezt' e fōrt,  
kudo gjëndet Arbënia,  
e kanosur ka një mōrt  
gjatullōre, po si ania  
je luftuome ka gjith ān 20  
ndër suvala prej t' e hān.

Tundu, e miken t' errëtīs  
bëj t' e shohmi ndonj hër,  
mos nga Bosfori je nxjerr,  
mbal Arbrīn të mos na rrjër 25  
si Harpī, cila të shqerr  
lë sa nget e sa rrëmbën,  
e njeriu së ja ndëlën.

Luonjin shpatat me fuqī,  
me të doq e t' egër shpīrt, 30  
tënët atje, moj kjo bëme  
pak i prothën, se të mīrt  
nëng e njohën, e, si ndë lëme  
mbjedhën grūrt, atena prana  
dreq e shprishnjin ndë gjith ana. 35

Të ndijgonjin po ku rrī  
mbë vërtet shëndeta e tire  
e çë lipset po të ngrëhen  
ndë një gjëll më të fanmire,  
maj mbë ta së kān të zëhen, 40  
se vëllau çë vëllaun vret  
mīr së sheh te mos një jët.

Kūr ndë Toskëra e ndë Ghueghëra  
më së t' jën ushrī e mënita?  
Kūr të njoh kanjë arbënesh 45  
gjuhën e tij, si njihet drita  
nd' errësīr, e kūr merr vesh  
një nga jetëri se jo shpata  
vet mbi dhë gadhnjën ndonata.

Mos të jën rrobij e bjeghëra 50  
kān të xën sa mundën fjala,  
cila shpirtin ëmbëlsōn  
e je ngrën, e ndë të fala



tas të gjithvet e rrëzōn.  
Karta, llivëre e pindiksī  
mūn të bēnjin kēt cjudhī. 55

Jān të shkruomet, po lēngonjin.  
Kush me stamb trīshūm i bēñ,  
po të nisen e të vēn  
përtej dētīt, tuke thēñ 60  
se, si atje, kētu pēllqēn  
të mbarohet zotēria  
mushkomēnde e madheshtia?

Zonj fōrmadhe, të dhuronjin  
mos ngē do prē mē tutje 65  
ata vlezēr, çē gjëllinjin  
përtej detit, mos i le  
nd' errēsīr e bēj të hinjin  
ëmbëlisht të xēn ndē karta  
po si Atena u mādhd e Sparta. 70

*I puthinj Dorën trīulētisht*

Demetrio Camarda pubblicò questo canto augurale nel suo volume *A Dora d'Istria gli Albanesi*, Tip. Fabbreschi, Livorno 1870.

*I testi poetici qui raccolti sono stati rinvenuti in fogli sparsi tra i manoscritti santoriani della Biblioteca Civica di Cosenza.*

*v. e.* = variante espunta dall'autore.